

Plani Strategjik Vendor  
për Rininë 2024-2027  
Bashkia Lezhë

*Draftimi i këtij dokumenti është mbështetur nga organizata Shoqata “Social Inclusion for Development” (SIFD) dhe Kongresi Rinor Kombëtar (KRK) në kuadër të programit Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022 me mbështetjen financiare të Bashkisë Tiranë dhe Kongresit Rinor Kombëtar me ekspertët/stafin si vijojnë:*

*Nga SIFD mbështeti me ekspertizë:*

*L. Topi*

*XH. Baxhaku*

*Nga KRK mbështeti me ekspertizë:*

*D. Peci*

*D. Gjokutaj*

## FJALA E KRYETARIT

Të nderuar qytetar dhe të rinj të Bashkisë Lezhë

Plani Strategjik Vendor për Rininë 2024-2027” është një shprehje e përpjekjeve tona për të siguruar një të ardhme më të ndritshme për të rinjtë tanë. Ne e kemi hartuar këtë plan me qëllimin e qartë për të adresuar sfidat dhe nevojat e rinisë sonë në Bashkinë tonë. Duke u fokusuar në arsimin e cilësuar, përmirësimin e mundësive për punësim, dhe promovimin e pjesëmarrjes aktive në jetën komunitare, synojmë të krijojmë një ambient të përshtatshëm për zhvillimin dhe përparimin e të rinjve. Në këtë proces, ne nuk jemi vetëm.

Ky plan është rezultat i një pune të gjatë dhe të përkushtuar për të adresuar nevojat dhe kërkesat e të rinjve tanë në komunitetin tonë. Përmes fokusit tonë në arsim, punësim, qasje në kulturë dhe pjesëmarrje aktive në jetën komunitare, ne dëshirojmë të sigurojmë që të rinjtë të kenë mundësinë për të arritur potencialin e tyre maksimal. Por, kjo nuk mund të arrihet vetëm me planifikim dhe strategji. Nevojitet përkushtim i vazhdueshëm dhe bashkëpunim i të gjithë aktorëve të komunitetit tonë.

Si Kryetar i Bashkisë, e shoh rininë si burim të potencialit tonë komunitar. Kjo është arsyeja pse jemi përkushtuar për të zhvilluar një plan që do të sigurojë që të rinjtë tanë të kenë mundësi reale për të zhvilluar dhe për të arritur ëndrrat dhe qëllimet e tyre. Këtë plan e shohim si një mjet për të përmirësuar jetën e të rinjve nëpërmjet ofrimit të shërbimeve cilësore të arsimit, trajnimit profesional, dhe punësimit. Për mua, është thelbësore që të rinjtë tanë të kenë mundësi të arrijnë një arsim të lartë dhe të gjejnë punë të qëndrueshme në komunitetin tonë. Në të njëjtën kohë, jemi të vendosur për të krijuar ambiente të sigurta dhe të inkurajojmë pjesëmarrjen e tyre aktive në jetën komunitare. Ne besojmë në fuqinë e angazhimit të rinisë në zgjidhjen e sfidave tona më të mëdha dhe në ndërtimin e një komuniteti më të fortë dhe më të lidhur. Me këtë plan, ne synojmë të krijojmë një mjedis ku të rinjtë tanë të ndjehen të mbështetur dhe të motivuar për të arritur potencialin e tyre të plotë.

## **Tabela e Përmbajtjes**

LISTA E AKRONIMEVE .....	3
1- 5	
2- 7	
<b>3. BASHKËRENDIMI ME KUADRIN LIGJOR, DOKUMENTAT STRATEGJIKË DHE POLITIKAT KOMBËTARE VENDORE DHE EUROPIANE .....</b>	<b>7</b>
3.1 KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL NË MBËSHTETJE TË SEKTORIT TË RINISË NGA NJVV-TË.....	7
3.2 POLITIKA DHE STRATEGJI NË NIVEL KOMBETAR.....	8
3.3 STRATEGJI NË NIVEL NDËRKOMBËTAR .....	11
3.4 STRATEGJI NË NIVEL LOKAL .....	13
<b>4. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE .....</b>	<b>18</b>
4.1 PASAPORTA E BASHKISË LEZHË.....	18
4.2 ANALIZË E PYETËSORIT DHE REZULTATEVE TË TRYEZAVE TË RRUMBULLAKËTA.....	26
<b>5. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT .....</b>	<b>31</b>
5.1 VIZIONI .....	31
5.2 OBJEKTIVAT STRATEGJIKE, PROGRAMET DHE INDIKATORËT .....	33
<b>6. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PSVR-së .....</b>	<b>37</b>
<b>7. BIBLIOGRAFIA .....</b>	<b>0</b>

## LISTA E AKRONIMEVE

AKDF	Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026
BE	Bashkimi European
BL	Bashkia Lezhë
DSKPA	Draft Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023-2030 (
INSTAT	Instituti i Statistikave
KB	Këshilli Bashkiak
KVR	Këshilli Vendor Rinor
NE	Ndihmë Ekonomike
NEET	Te rinj jo ne arsim, punësim apo formim
NJA	Njësia Administrative
NJQV	Njësia e Qeverisjes Vendore
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PAK	Persona me aftësi të kufizuar
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PKVIRE	Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025
PSVR	Plani Strategjik Vendor për Rininë 2023-2027
SKA	Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026
SKR	Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-2029
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
UN	Kombet e Bashkuara
UNDP	United Nations Development Programme
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak

# 1- PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Politikat dhe dokumentat strategjike janë instrumenta që udhëheqin sektorë të veçantë, në përputhje me funksionet e institucioneve dhe kuadrin ligjor. Hartimi i një dokumenti strategjik për sektorin e rinisë është e parashikuar në Planin Strategjik për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030 (PSZHQ) në Qëllimin *'Cilësia e jetës dhe komuniteti'*. Ndërkohë në tërësi ky dokument synon të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm, duke përfshirë atë ekonomik, social, mjedisor e kulturor.

Vizioni i PSVR-së është *'Vendosja e rinisë në fokus të jetës aktive'*. Në këtë frymë, PSVR synon të nxisë aktivizmin rinor dhe rritjen e kapaciteteve për të rinjtë në mënyrë që ata të kenë më shumë mundësi dhe hapësira në të ardhmen. Nën këtë vizion, PSVR projektin krijimin e kushteve dhe një mjedisi të sigurt për një rini aktive dhe të barabartë në të gjitha fushat e jetës dhe me status të konsoliduar për të ardhmen e tyre. Prioritet është përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së jetës së të rinjve dhe forcimi i statusit të tyre, përmes zhvillimit të më shumë mundësive në edukim, punësim, kulturë dhe sigurimin e mundësive për pjesëmarrje të të rinjve në shoqëri dhe vendimmarrje.

Pesë shtyllat kryesore mbi të cilat bazohet PSVR janë në harmoni dokumentat strategjike në nivel qendror, vendor dhe evropian për mbështetjen e zhvillimit të potencialit rinor. Në evidentimin e këtyre shtyllave rol të rëndësishëm patën analiza e situatës aktuale në fusha të cilat janë nën kompetencë të Bashkisë Lezhë, si dhe sugjerimet/rekomandime nga të rinjtë e BL-së duke formuluar këto objektiva:

- ❖ **Hapësirat dhe infrastruktura rinore:** Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet investimeve konkrete në infrastrukturën arsimore në të gjithë territorin e BL-së si dhe në hapësira dhe infrastrukturë me destinacion zhvillimin e aktiviteteve rinore.
- ❖ **Edukimi jo-formal i të rinjve dhe rekreacioni.** Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet organizimit të veprimtarive për të rinjtë jashtë sistemit arsimor parauniversitar, nëpërmjet bashkëpunimit me organizatat rinore ku ata zhvillojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre kryesisht në fushën e mjedisit, kulturës dhe artit, mbrojtjen e trashëgimisë historike-kulturore, dhe përfshirjen në jetën sportive.
- ❖ **Përfaqësimi, pjesëmarrja dhe integrimi në BE.** Ky objektiv do të realizohet nëpërmjet zbatimit të projekteve konkrete lidhur me rritjen e përfaqësimit të të rinjve në proceset e vendimmarrjes në BL, ndërgjegjësimin dhe edukimin e të rinjve për pjesëmarrjen në proceset zgjedhore si e drejtë demokratike e shprehjes së vullnetit duke projektuar kështu rininë si aleatin e saj më të mirë në

bashkëqeverisjen e saj. Po ashtu do të synohet informimi mbi programe dhe mundesi të BE-se për të rinjtë shqiptarë.

- ❖ **Siguria Sociale për të rinjtë.** Ky objektiv do të garantojë ngritjen dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve të përkujdesit social vendor dhe fuqizimin e bashkëpunimit të BL-së me organizatat rinore dhe organizatat që punojnë edhe për rininë, me fokus parandalimin e fenomeneve të rrezikshme sociale.
- ❖ **Mbështetja financiare dhe nxitja e punësimit.** Nën këtë objektiv parashikohen politika/projekte dhe aktivitete të cilat prodhojnë skema dhe mekanizma nxitës dhe lehtësues për të rinjtë që dëshirojnë të hapin biznesin e tyre (start-up) ose të zhvillojnë biznesin ekzistues, si dhe përgatitja e tyre për në tregun e punës.

## 2- METODOLOGJIA

Për hartimin e analizës së situatës dhe evidentimit të objektivave kryesorë të PSVR-së janë përdorur metoda mikse cilësore dhe sasiore duke hulumtuar në burime parësore dhe dytësore. Është draftuar dhe publikuar pyetësi i cili synoi të masë perceptimin e të rinjve në Bashkinë Lezhë mbi problematikat rinore dhe sugjerimet për çështjet që do të dëshironin të adresoheshin në PSVR. Pyetësi përbëhet nga tetë pyetje nga të cilat: 5 janë pyetje nga sektori statistikor/demografik; 2 pyetje mbi çështjet kryesore me të cilat përballet rinia në Bashkinë Lezhë që pjesëmarrësit konsiderojnë si më problematike; 1 pyetje e hapur mbi çështjet që sipas pjesëmarrësve janë më të rëndësishmet për tu përfshirë në PSVR.

Konsultimi publik paraprak me të rinjtë dhe aktorë të BL-së u realizua edhe nëpërmjet tryezave të diskutimit me të rinjtë. Gjetjet nga procesi i konsultimit paraprak kanë mbështetur analizën e situatës mbi perceptimin e të rinjve dhe adresimin drejt formulimit të objektivave kryesore.

Konsultimi me kuadrin ligjor i cili rregullon funksionet, detyrat kryesore të NJQV-ve, kryesisht me Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” si dhe Ligjit 79/2019 ‘Për rininë’ është i rëndësishëm për të identifikuar ndërhyrjet të lejueshme për NJVV-të. Paralelisht me kuadrin ligjor, PSVR është mbështetur gjithashtu në objektivat e dokumentave strategjike dhe politikave kombëtare, vendore, rajonale dhe evropiane për të krijuar një kuadër zhvillimor koherent dhe të qëndrueshëm dhe sa më pranë standardeve të Bashkimit Europian (BE). Në kuadër të analizës së situatës por dhe planifikimit, janë referuar dhe të dhëna nga strukturat e Bashkisë apo dokumente të publikuara prej saj si dhe materiale të tjera zyrtare të publikuara nga institucone si vjetarët statistikorë, studime, raporte zyrtare, e të tjera.

Në përfundim dhe të këtij procesi, u hartua drafti i PSVR-së i të zbërthyer në programe, dhe projekte/aktivitete të detajuara së bashku me indikatorët përkatës. Këta të fundit do të ndihmojnë në rritjen e efikasitetit të procesit të monitorimit dhe vlerësimit të PSVR-së për të siguruar dhe garantuar arritjen e objektivave që përcakton ky dokument. Vëmendje e veçantë i është kushtuar procesit të monitorimit të indikatorëve dhe vlerësimit të PSVR-së, si edhe strukturave përgjegjëse për këtë detyrë, në mënyrë që të ketë koordinim dhe fokusim në përmbushjen e objektivave. Struktura e BL-së përcakton target, bazën e të dhënave dhe frekuencën e raportimit për secilin indikator nga njësitë përgjegjëse. Formati/matrica e raportimit është bashkëlidhur në kapitullin mbi monitorimin dhe vlerësimin.



## 2.1 PROCEDURAT E NDJEKURA NGA BASHKIA LEZHË

Bashkia Lezhë pas marrjes në dorëzim të “Draft Planit Strategjik Vendor Për Rininë 2023-2027” dorëzuar nga organizata “Social Inclusion for Development”, ka ngritur një grup pune për shqyrtimin e “Planit Strategjik Vendor Për Rininë 2024-2027”

## 3. BASHKËRENDIMI ME KUADRIN LIGJOR, DOKUMENTAT STRATEGJIKË DHE POLITIKAT KOMBËTARE VENDORE DHE EUROPIANE

Vizioni i PSVR-së është ‘Vendosja e rinisë në fokus të jetës aktive’. Në mënyrë që të realizohet ky vizion afatmesëm, është parësore që të bashkërendohet me planet dhe politikat kombëtare dhe të ketë koordinim më efikas me organizatat rinore dhe aktorët e tjerë të përfshirë në këtë proces. Si vijon do referohet kuadri ligjor dhe dokumentat strategjikë kryesorë mbi rininë në nivel kombëtar, vendor dhe ndërkombëtar me të cilat PSVR harmonizohet.

### 3.1 KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL NË MBËSHTETJE TË SEKTORIT TË RINISË NGA NJVV-TË

#### ***Ligji 75/2019 ‘Për rininë’***

Objekti i këtij ligji është mbrojtja e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimi i kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, përcaktimi i funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, si dhe bashkëpunimi me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë.

Ligji për Rininë specifikon moshën e të konsideruarit i ri duke specifikuar personat nga 15 deri në 29 vjeç. Ligji përcakton aktivitetet, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve si në Shqipëri dhe diasporë dhe rrit pjesëmarrjen e të rinjve në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Ligji u miratua për të mbrojtur të drejtat e të rinjve dhe për të krijuar kushte për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e tyre.

Ky ligj përkufizon disa koncepte të rëndësishme në sektorin e rinisë si ai i: edukimit joformal për të rinjtë; dialogut të strukturuar mes të rinjve; organizatave rinore; organizatat për të rinjtë apo “Politikat rinore”. Ndër të tjera në nenin 7 të këtij ligji përcaktohen përgjegjësitë e

NJVV-ve të cilët në përputhje me funksionet e tyre, hartojnë dhe zbatojnë politikat vendore në fushën e rinisë, si dhe janë përgjegjëse për:

- pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të të rinjve, duke përcaktuar objektivat dhe prioritetet, si dhe të garantojnë zbatimin e tyre;
- krijimin e këshillit vendor të rinisë;
- organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendore në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve;
- organizimin dhe ofrimin e veprimtarive për të mbështetur mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve;
- nxitjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimin joformal të tyre;
- financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta;
- krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë;
- parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore;
- mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera, për situatën e të drejtave të të rinjve në territorin e tyre.

### ***Ligji 25/2022 'Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve'***

Ligji për start-up, i miratuar në 2022, krijon mundësi për të rinjtë dhe gratë e reja si në trajnime ashtu edhe në mbështetjen e ideve të tyre për biznes. Qëllimi i këtij ligji është hartimi i një kuadri rregullator dhe institucional të favorshëm për krijimin e zhvillimin e startup-eve dhe mbështetjen e ekosistemit të tyre, për nxitjen e kërkimit, realizimit dhe përdorimit të ideve inovative, si dhe modeleve, produkteve dhe proceseve të reja, të cilat sjellin risi në çdo fushë për zhvillimin ekonomik. Ky ligj përcakton rregullat bazë, procedurat, si dhe organet shtetërore kompetente për vetëdeklarimin, mbështetjen, zhvillimin dhe monitorimin e startup-eve dhe të ekosistemit mbështetës të tyre në Republikën e Shqipërisë.

## **3.2 POLITIKA DHE STRATEGJI NË NIVEL KOMBETAR**

### ***Programi qeverisës 2021–25***

Në aspektin e zhvillimit ekonomik programi qeveritar qëndron angazhimi për të mundësi reale për të qenë sipërmarrësit e ardhshëm në fushat e inovacionit e teknologjisë, për të konkurruar denjësisht në tregun global. Në lidhje me zhvillimin e shoqërisë së dijes synon rindërtimin e sistemit arsimor për ta bërë atë më të aksesueshëm dhe me infrastrukturë moderne duke i nxitur të rinjtë në shkenca, teknologji, inxhinieri dhe matematikë, fusha që

garantojnë jo vetëm një të ardhme të sigurt për ta, por edhe zhvillimin dhe konkurrueshmërinë e vendit.

Në lidhje me arsimin pritet të arrihen investime në teknologji dhe infrastrukturë laboratorike, rritjen e vlerës së diplomave në tregun e punës, si dhe fuqizimin e institucioneve vendase të arsimit të lartë. Zinxhiri i arsimit pret rritje cilësore edhe duke bërë të detyrueshëm mësimin e gjuhës angleze nga klasa e parë fillore, hapjen e kurseve të kodimit dhe profilizimin e klasave sportive. Në procesin e zhvillimit të biznesit të vogël merr edhe më shumë vëmendje sipërmarrja e krijuar nga të rinjtë. Fondi i mbështetjes për sipërmarrjet e reja start-up pesëfishohet për të arritur në 10 milionë euro. Edhe në zhvillimin e fshatit drejt turizmit rural programi ka parashikuar paketa nxitëse për të rinjtë dhe gratë që do të përfshihen në këtë sektor.<sup>1</sup>

### **Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-2029**

Vizioni i kësaj strategjie synohet të jetësohet përmes tre qëllimeve të politikës:

- ❖ Qëllimi i politikës 1: Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar.
- ❖ Qëllimi i politikës 2: Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.
- ❖ Qëllimi i politikës 3: Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti).

*Disa nga masat që synohet të jetëzohen për të rinjtë nga apo në bashkëpunim nga NJVV-të janë:*

- Mirëinformimi i të rinjve rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike.
- Mbrojtja, mbështetja dhe siguria e të rejave dhe të rinjve, veçanërisht e atyre në situatë rreziku, në vendin ku jetojnë dhe hapësirën digjitale.
- Mbështetja e të rinjve në përfshirjen dhe integrimin e tyre në shoqëri dhe kanë mundësi rekreative dhe kulturore, duke përfshirë artet dhe sportet.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup>Programi Qeverisës 2021-2023, i disponueshëm në:

[https://kryeministria.al/wpcontent/uploads/2021/10/Programi\\_Qeverises\\_2021-2025.pdf](https://kryeministria.al/wpcontent/uploads/2021/10/Programi_Qeverises_2021-2025.pdf)

<sup>2</sup>Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 692, datë 26.10.2022

'Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe planit të Veprimit', 2022-2029

## ***Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026 (SKA)***

SKA 2021–26 i kushton rëndësi zhvillimit të plotë të të rinjve si brenda dhe jashtë shkollës duke krijuar mundësi për zhvillimin digjital në arsim dhe revolucionarizimin e orës së mësimit, por edhe duke ndërtuar masa specifike për aktivitetet pas mësimit.

*Disa nga masat që synohet të jetëzohen për të rinjtë nga apo në bashkëpunim nga NJVV-të janë:*

- Krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për shfrytëzimin e TIK-ut në shkolla dhe mirëmbajtja e saj.
- Mirëmbajtja teknike e pajisjeve të TIK-ut përmes klubeve të nxënësve dhe strukturës arsimore lokale.
- Përmirësimi i statusit socioekonomik të studentëve përmes ofrimit të shërbimeve cilësore dhe formave të ndryshme të ndihmës financiare.
- Zgjerimi i listës së shërbimeve të favorizuara për studentët mbi bazën e kartës së studentit.<sup>3</sup>

## ***Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 (AKDF)<sup>4</sup>***

AKDF parashikon tërësi masash të cilat kërkojnë angazhim dhe vullnet të NJVV-ve për tu realizuar, si përshembull:

- Ngritja e mekanizmave vendorë për iniciativën e qyteteve miqësore.
- Fuqizimi i kapaciteteve të fëmijëve dhe adoleshentëve për realizimin e një pjesëmarrjeje të dobishme.
- Zhvillimi i programeve të edukimit digjital UPSHIFT, Ponder për fëmijët në sipërmarrje, aftësim digjital, inovacion social, qytetari aktive, avokati, mendim kritik dhe mendim mediatik.
- Zgjerimi dhe përdorimi i teknologjisë digjitale dhe platformave inovative si “U-report” për të realizuar të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar për të ngritur zërin për çështje që i prekin nga afër online dhe offline.
- Planifikimi i buxheteve për sigurimin e materialeve didaktike sipas kërkesave të veçanta të kategorive të ndryshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

---

<sup>3</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 22.10.2021, ‘Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj’

<sup>4</sup> Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 659, datë 3.11.2021 “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026

- Ngritja e shërbimeve argëtuese dhe kulturore në NJVV.
- Krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për shfrytëzimin e TIK-ut në shkolla dhe mirëmbajtja e saj.
- Shtrirja e modelit BiblioTech pranë bibliotekave të qytetit për aftësimin digjital dhe mbrojtjen online në 4 bashki të reja.
- Hartimi i kurrikulës së aftësimit digjital pranë Bibliotech's.

### ***Draft Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023-2030 (DSKPA)***

Ky dokument deri në muajin mars 2023 nuk është miratuar ende dhe drafti është publikuar në platformën e Konsultimit Publik. Përveç rritjes së cilësisë dhe ofertës së arsimit e formimit profesional synohet të hapen një sërë programesh që mbështesin e nxisin punësimin e të rinjve.

Një nga masat të cilat synojnë bashkëpunimin me NJVV-të është:

- *Konsolidimi i mekanizmave të këshillimit dhe orientimit për karrierë dhe të nxënit gjatë gjithë jetës* (Bashkitë)<sup>5</sup>

Gjithashtu pjesë e kësaj strategjie planifikohet të jenë një sërë masash në mbështetje të skemës së Garancisë Rinore (*Youth Guarantee*) në Shqipëri në zbatim të Rekomandimit e Këshillit (prill 2013). Kjo skemë është angazhim nga të gjitha Shtetet Anëtare të BE dhe po shtrihet në të gjithë vendet e Ballkanit Perëndimor, për të siguruar që të gjithë të rinjtë nën moshën 29 vjeç marrin një ofertë cilësore brenda një periudhe katër mujore të regjistrimit si punëkërkues të papunë ose të braktisjes së arsimit formal, për programet e mëposhtme: - punësim;- edukim i vazhdueshëm (continued education); - mësim profesioni (apprenticeship); - trajnim profesional. Nevoja për një program të tillë në BE erdhi për arsye të rritjes së papunësisë rinore dhe sidomos të atyre që u përkasin grupit të rinj as në punësim, arsim apo aftësim APAA (*NEET not in employment, education or training*). NJVV-të dhe partnerët socialë janë të rëndësishëm në zbatimin e Garancisë Rinore në fazat e implementimit të saj. Më shumë informacion mbi angazhimin e tyre pritet të publikohet me miratimin e DSKPA dhe Planit të zbatimit të Garancisë Rinore.

### ***Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2021– 2025 (PKVIRE)***

PKVIRE ka për synim heqjen e pengesave me të cilat përballen romët dhe egjiptianët sa i përket aksesit në shërbime dhe përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës, nëpërmjet integritit dhe nxitjes së dialogut ndërkulturor. Parashikon tërësi masash të cilat kërkojnë angazhim dhe vullnet të NJVV-ve për tu realizuar, si përshembull:

---

<sup>5</sup>Draft Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023-2030, <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/561>

- Organizim i programeve të veçanta mbaschkollore ku nxënësit romë dhe egjiptianë të moshës 6-16 vjeç të ndihmohen në kryerjen e detyrave mësimore ose marrin mësim plotësues.
- Rritja e subvencionimit shtesë, pjesë e skemës së ndihmës ekonomike, për nxënësit romë dhe egjiptianë që ndjekin rregullisht arsimin e detyrueshëm.
- Përcaktimi i kriterëve për dhënien e bursës financiare për nxënës romë dhe egjiptianë që ndjekin gjimnazin , arsimin e mesem profesional dhe arsimin e mesem të orientuar.

### 3.3 STRATEGJI NË NIVEL NDËRKOMBËTAR

#### ***Strategjia e OKB-së për rininë 2030***<sup>6</sup>

Kjo strategji mbështetet në vizionin global të një bote ku të drejtat njerëzore të çdo të reje dhe të riu bëhen realitet; ku sigurohet se çdo e re apo i ri fuqizohet për të arritur potencialin e vet të plotë; dhe që e njej kapacitetin, qëndrueshmërinë dhe kontributet pozitive të të rinjve si agjentë të ndryshimit. Të pajisur me aftësitë dhe mundësitë e nevojshme për të arritur potencialin e tyre, të rinjtë mund të jenë një forcë shtytëse për mbështetjen e zhvillimit dhe kontributin për paqen dhe sigurinë. Nga perspektiva e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ) është veçanërisht e rëndësishme të mos lihet asnjë i ri apo fëmijë mbrapa e pa zhvillim. OZHQ-të që lidhen drejtpërsëdrejti me të rinjtë dhe të rejtat dhe zhvillimin e tyre në këtë PSVR janë:

- OZHQ 3 – shëndet i mire dhe mirëqenie.
- OZHQ 4 – arsim cilësor lidhet ngushtë me mundësitë më të mira për punësim dhe ngjitjen e shkallëve të larta në profesion duke lënë pas varfërinë.
- OZHQ 5 – barazia gjinore me zhvillimet që kanë ndodhur në Shqipëri tregon se ajo është një themel i nevojshëm për zhvillimin e qëndrueshëm dhe paqësor.
- OZHQ 8 – punë dinjitoze dhe rritje ekonomike
- OZHQ 13 – veprimi për klimën në një situatë globale ku secili vit arrin rekorde më të larta të ngrohjes globale se tjetri dhe ku cilësia e ajrit dhe ujit është në ulje kërkon angazhimin e të rinjve dhe organizatave rinore për të sjellë ndryshim në qasjen globale kundrejt këtij fenomeni.

#### ***Strategjia Evropiane e Rinisë***

---

<sup>6</sup> United Nations, Youth 2030, 'Working with and for young people', [b1d674\\_9f63445fc59a41b6bb50cbd4f800922b.pdf](https://www.un.org/youth2030/) ([un youth2030.com](https://www.un.org/youth2030/))

Strategjia Evropiane e Rinisë bazohet në 11 qëllime për të rinjtë në Evropë. PSVR bazohet në këto qëllime: 1. Lidhja e BE-së me rininë; 2. Barazia mes të gjitha gjinive; 3. Shoqëria gjithëpërfshirëse; 4. Dialog konstruktiv dhe shpërndarje informacionesh; 5. Shëndeti mendor dhe mirëqenia; 6. Nxitje dhe përparësi për rininë rurale; 7. Punësim cilësor për të gjithë; 8. Të mësuarit cilësor; 9. Hapësirë dhe pjesëmarrje për të gjithë; 10. Evropa e gjelbër dhe e qëndrueshme.<sup>7</sup>

### ***Strategjia e Rinisë së Këshillit të Evropës***

Kjo strategji ka si qëllim të inkurajojë të rinjtë anembanë Evropës që aktivisht të mbështesin, mbrojnë, nxisin dhe përfitojnë nga vlerat thelbësore të Këshillit të Evropës të të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Objektivat strategjikë të këtij dokumenti synojnë të rrisin angazhimin dhe pjesëmarrjen e të rejave dhe të rinjve në proceset demokratike, forcimin e të drejtave të njeriut dhe në vendimmarrje. Këshilli i Evropës në dokumentin e tij strategjik për rininë ka synuar këto prioritetet tematike: rigjallërimi i demokracisë pluraliste; aksesin e të rinjve në të drejta; jetesën e përbashkët në shoqëri gjithëpërfshirëse; puna rinore

### ***Agjenda e Ballkanit Perëndimor për novacionin, kërkimin shkencor, arsimin, kulturën, rininë dhe sportet***<sup>8</sup>

Paraqet një strategji dhe kornizë afatgjatë të bashkëpunimit ekonomik duke dhënë njëkohësisht një vizion pozitiv dhe largpamës në veçanti për rininë bazuar në: 1. Mbështetja e transformimit digjital; 2. Nxitja e zbatimit të Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor dhe pesë shtyllat e saj; 3. Nxitja dhe mbështetja e qarkullimit të trurit në veçanti me diasporën e Ballkanit Perëndimor; 4. Ngritja e standardeve të larta të cilësisë së arsimit profesional evropian dhe trajnimit si referencë për zhvillimin e aftësive, duke përfshirë mikrokredencialet.

## **3.4 STRATEGJI NË NIVEL LOKAL**

### **Plani Strategjik për Zhvillimin e Qëndrueshëm në Bashkinë Lezhë 2030**

---

<sup>7</sup> European Union, Resolution of the Council of the European Union and the Representatives of the Governments of the Member States meeting within the Council on a framework for European cooperation in the youth field: The European Union Youth Strategy 2019-2027, Official Journal of the European Union, C 456, Volume 61, 18 December 2018, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=OJ:C:2018:456:FULL>

<sup>8</sup> Western Balkans Agenda on Innovation, Research, Education, Culture, Youth & Sport, [ec\\_rtd\\_western-balkans-agenda-overview.pdf](https://ec.rtd.western-balkans-agenda-overview.pdf) (europa.eu),

PSZHQBL ofron një kornizë të konsoliduar politikash multi-sektoriale afatmesme dhe afatgjata dhe orienton strategjitë, planet sektoriale të Bashkisë, duke i kontribuar njëkohësisht rritjes së efektivitetit të menaxhimit të punëve dhe shërbimeve bashkiake. Përbëhet nga 7 qëllime si vijojnë: 1. Turizimi, Kultura dhe Arkeologjia; 2. Ekonomia dhe Sipërmarrja; 3. Zhvillimi Hapësinor dhe Infrastruktura; 4. Cilësia e Jetës dhe Komunitet; 5. Mjedisi dhe Shërbimet Publike; 6. Dija dhe Zhvillimi Njerëzor; 7. Qeverisja Bashkiake. Disa prej këtyre qëllimeve adresojnë masa konkrete lidhur me rininë të cilat do të referohen më konkretisht si vijon.

Qëllimi 'Turizimi, Kultura dhe Arkeologjia' ka disa masa që janë planifikuar të kontribuojnë direkt dhe në grupmoshën 15-29 vjeç:

- Pasurimi i jetës kulturore dhe komunitare që mundëson përparimin shpirtëror e kulturor të banorëve dhe ndërveprime shqërore të harmonishme mes njerëzve dhe brezave;
- Zhvillimi i kulturës dhe krijimitarisë për komunitetin;
- Ndërtimi i dhomës për muzikën në Pallatin e Kulturës;
- Ndërtimi i sallës për artin alternativ në Pallatin e Kulturës;
- Nxitja e ngritjes së kinemasë në qytet;
- Shkëmbimet kulturore rajonale të komunitet;
- Ngritja e Qendrës Rinore;
- Rritja e aftësive, aksesit dhe përfshirjes dixhitale të komunitetit në shoqërinë e informacionit ;
- Shtimi i shanseve integruese, pasurimi dhe modernizmi i jetës së fëmijëve, të rinjve, grave dhe vajzave;
- Shtimi i mjediseve cilësore dhe i masave që garantojnë një jetesë aktive, të shëndetëshme dhe të sigurtë për qytetarët e të gjithë grupmoshave;

Qëllimi 'Dija dhe zhvillimi njerëzor' synon të ktheje Lezhën në një qytet universitar, ku dijet e avancuara dhe profesionalizmi garantojnë ritmet e zhvillimit ekonomik e njerëzor, dhe mbështesin ambicien, inovacionin dhe integrimin e rinisë. Masat në këtë kuadër janë si:

- Ngritja në qytet e qendrave universitare e kërkimore që nxisin dhe inkurajojnë dijet e avancuara për të rinjtë dhe mbështesin zhvillimin e qytetit;
- Rritja e aftësive dhe kualifikimeve profesionale të fuqisë punëtore që mundëson përfshirje aktive të të dy gjinive në tregun e punës dhe jetën shoqërore të qytetit;
- Rritja e cilësisë së dijës dhe standarteve të mësimdhënies dhe aksesit në arsimin parauniversitar.

Në qëllimin 'Demokracia dhe qeverisja vendore', synon qeverisje bashkiake efiçente, e hapur, përfshirëse e moderne që mundëson arritjen e vizionit për zhvillimin e qëndrueshëm



të qytetit dhe integrimin e komunitetit në hapësirën evropiane të zhvillimit. Disa nga masat nën këtë qëllim janë:

- Modernizimi i politikëbërjes dhe rritja e cilësisë dhe efijencës së ekzekutivit bashkiak për të mundësuar zhvillim të qëndrueshëm të bashkisë dhe ofrimin e shërbimeve me standarte evropiane.
- Ngritja dhe përparimi inovator i qeverisjes inteligjente e elektronike bashkiake që garanton shërbime cilësor dhe ndërveprim aktiv e demokratik me qytetarët dhe bizneset;
- Fuqizimi i demokracisë vendore me pjesëmarrje aktive të komunitetit në vendimmarrjen e qeverisë bashkiake.

Qëllimi 'Ekonomia dhe sipërmarrja' synon arritjen e një ekonomie konkurruese, me zhvillim dinamik të ndërmarrjeve të vogla e të mesme, mbështetur në industri mjedisore dhe teknologji inovative e që nxit investimet e shanset e barabarta për sipërmarrjet. Disa nga masat që targetojnë dhe të rinjtë janë si:

- Fuqizimi ekonomik dhe rritja e sipërmarrjes së të rinjve, grave dhe vajzave dhe njerëzve me sfida shoqërore;
- Infrastruktura dhe kapacitetet për sipërmarrje e të rinjve grave dhe vajzave;
- Ngritja e inkubatorit të biznesit social;
- Hartimi i paketës rregullatore për inkubatorin e biznesit;
- Mbajtja e panairit vjetor të ideve inovatore të të rinjve grave dhe vajzave për biznes;
- Hartimi i paketës rregullatore për inkubatorin e biznesit;

Qëllimi 'Cilësia e jetës dhe komuniteti' synon komunitet me jetë të shëndetëshme dhe aktive, me angazhim kulturor të larmishëm e ndërveprim shoqëror të harmonishëm, që mbështet barazinë gjinore, përfshirjen sociale në një shoqëri të informacion. Disa nga masat e planifikuara janë:

- Shtimi i shanseve integruese, pasurimi dhe modernizmi i jetës së fëmijëve, të rinjve, grave dhe vajzave;
- Zhvillimi bashkëkohor i fëmijëve Festivali i fëmijëve të shkollave 9–vjeçare;
- Fëmijët në programet rajonale;
- Organizmi i kurseve të rrobaqepsisë dhe të kompjuterit për gratë dhe vajzat në nevojë;
- Zhvillimi bashkëkohor i rinisë me organizimin e festave me të rinj në të gjithë lagjet e qytetit;
- Organizimi i Ditës së Rinisë;
- Festival i zërave të rinj;

- Zhvillimi i strategjisë për rininë.<sup>9</sup>

### **Programi Buxhetor Afatmesëm<sup>10</sup>**

Programi Buxhetor Afatmesëm është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e

disavjecar të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare, për planifikimin, menaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, është një komponent kryesor i planifikimit. Orientimi afatgjatë i Bashkisë Lezhë shprehet në tre objektiva mbi të cilën bazohet dhe PBA 2023-2025:

- Objektivat Strategjik 1: Turizëm i Qëndrueshëm. Lezha, hapësirë me potenciale turistike, vlera bujqësore, natyrore dhe kulturore.
- Objektivi Strategjik 2: Industria Agro-Ushqimore. Lezha, poitikal bujqësore, atraktive për investitorët strategjike në fushën e industrisë agro-ushqimore.
- Objektivi Strategjik 3: Facilitete dhe Shërbime. Lezha për qytetarët, ku do të ofroje shërbime efiçente, cilësore dhe gjithëpërfshirëse.

PBA 2023-2025 është e përbërë nga 20 programe buxhetore (Tabela 2) në të cilat parashikohen masa dhe aktivitete të cilat targetojnë komunitetin në tërësi. Edhe pse nuk ka një program buxhetor të dedikuar specifikisht programeve/projekteve për grupmoshën e rinisë, kjo grupmoshë, si pjesë e popullsisë së përgjithshme të komunitetit, përfiton nga masa/aktivitete/financime të mbështetura në programe të ndryshme buxhetore siç janë ato më kryesoret si ato: ‘Sport dhe Argëtim’; ‘Trashëgimi kulturore, eventet artistike dhe kulturore’; ‘Arsimi i mesëm i përgjithshëm’, ku mbështeten dhe investimet më të mëdha kapitale në infrastrukturën shkollore; ‘Kujdesi social për familjet dhe fëmijet’ për kategoritë vulnerabël; ‘Përkujdesja sociale’ dhe ‘Strehimi social’. Këto programe janë parësore për të identifikuar masat e buxhetuara nga Bashkia Lezhë në mbështetje të rinisë të kategorizuara sipas objektivave të PSVR-së.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të gjitha programet buxhetore të PBA 23-25.

**Tabela 2- Programet buxhetore 23-25:**

Programi 1	01110: Planifikim, menaxhim dhe administrim
Programi 2	03140: Shërbimi i policisë vendore

<sup>9</sup> Bashkia Lezhë, Plani Strategjik për Zhvillimin e Qëndrueshëm në Bashkinë Lezhë 2030, [https://lezha.gov.al/wp-content/uploads/2021/06/plani\\_strategjik\\_bashkia\\_lezhe\\_alb\\_730.pdf](https://lezha.gov.al/wp-content/uploads/2021/06/plani_strategjik_bashkia_lezhe_alb_730.pdf)

<sup>10</sup> Ibidem.

Programi 3	03280: Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe mbrojtja civile
Programi 4	04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik
Programi 5	04220: Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve
Programi 6	04240: Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit
Programi 7	04260: Administrimi i pyjeve dhe kullotave
Programi 8	04520: Rrjeti rrugor
Programi 9	04570: Transporti publik
Programi 10	05100: Menaxhimi i mbetjeve
Programi 11	06140: Planifikimi urban vendor
Programi 12	06260: Shërbimet publike vendore
Programi 13	06370: Furnizimi me ujë
Programi 14	07220: Shërbimi i kujdesit parësor
Programi 15	08130: Sport dhe argëtim
Programi 16	08220: Trashigimia kulturore, evente artistike dhe kulturore
Programi 17	09120: Arsimi parashkollor dhe bazë
Programi 18	09230: Arsimi i mesëm i përgjithshëm
Programi 19	10430: Përkujdesja sociale
Programi 20	10661: Strehimi social

Aktualisht buxheti i projektuar për aktivitete për të rinjtë në Programin Buxhetor Afatmesëm për aktivitete për rininë është me vlerë 1.293.000 leke si më poshtë:

- Konkurs debati mes nxënësve të institucioneve arsimore publike dhe private.
- Vizita kulturore mes shkollave të njësive administrative.
- Aktivitet për Ditën e Rinisë.
- Shperblimi i maturantëve më të mirë.
- Fushata sensibilizimi/ndergjegjësimi për mjedisin.
- Fuqizimi i të rinjve të Keshillit Vendor Rinor.
- Art Fest Lissus.<sup>11</sup>

---

<sup>11</sup> Bashkia Lezhë, Përgjigje shkresës nr. 2882/1 Prot. date 16.03.2023



## **Vendndodhja Gjeografike**

Lezha kufizohet në veri me Bashkitë e Vaut të Dejës dhe Pukës, në perëndim me Detin Adriatik, në lindje me Bashkinë e Mirditës dhe në jug me Bashkinë Kurbin. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Lezhës. Sipas Censurit të vitit 2011, Lezha ka 65,633 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 106,245 banorë. Me një sipërfaqe prej 509.1 km<sup>2</sup>, bashkia e re e Lezhës ka një densitet prej 208.69 banorë/km<sup>2</sup> sipas të dhënave të Regjistrimit Civil dhe 128.91 banorë/km<sup>2</sup> sipas Censurit 2011.

Trashëgimia e pasur historike dhe kulturore e bën këtë bashki një destinacion tërheqës për turizmin kulturor. E shtrirë në të dy anët e lumit Drin, e rrethuar nga lagunat Kunë e Vain si dhe nga plazhi i bukur i Shëngjinit, Lezha ofron bukuri natyrore të larmishme dhe mundësi të shumta për zhvillimin e turizmit jo vetëm brenda territorit të saj, por edhe në një distancë të afërt. Pozicioni i favorshëm gjeografik mundëson akses në të mirat bujqësore, të agrikulturës, blegtorisë dhe peshkimit, të cilat ndikojnë gjithashtu në potencialin ekonomik dhe rritjen e punësimit në Bashki.

Për sa i përket Njësitë Administrative dhe nënndarjet e tyre, Bashkia Lezhë përbëhet nga 2 Qytete (Lezha dhe Shëngjini) dhe 65 Fshatra:

- Nj.A Lezhë: Qyteti Lezhë
- Nj.A Shëngjin- Qyteti Shëngjin, Fshatrat: Ishull-Shëngjin, Ishull-Lezhe, Mali-Rencit, Mali-Shën-gjin, Kodër Mulliri.
- Nj.A Zejmen: Fshatrat: Zejmen, Tresh, Pruell, Bërzane, Pllanë, Markatomaj, Spiten.
- Nj.A Shënkoll- Fshatrat: Shënkoll, Tale1, Tale 2, Barbullojë, Grykë-Lumi, Gajush, Alk, Rrilë.
- Nj.A Balldre- Fshatrat: Balldre i Vjetër, Mali-Kakarriq, Qëndër-Kakarriq, Balldren i Ri, Gocaj, Torovicë, Malecaj, Kolajakaj.
- Nj.A Kallmet- Fshatrat: Kallmet i Madh, Kallmet i Vogël, Rraboshtë, Mërqi.
- Nj.A Blinisht- Fshatrat: Blinisht, Troshan, Fishtë, Krajën, Piraj, Baqel, Kodhel.
- Nj.A Dajç- Fshatrat: Dajç, Gjadër, Gramsh, Mabë, Dragushë, Kotërr, Zojs.
- Nj.A Ungrej- Fshatrat: Ungrej, Kashnjet, Gjobardhaj, Kalivaç, Rras i Butë, Sukaxhi, Fregen, Zimaj, Kaluer
- Nj.A Kolsh- Fshatrat: Kolsh, Gjash, Kacinar, Patalej, Lalm, Lalm-Lukaj, Manati, Velë, Grykë-Manati, Barbullojë e Re.

## **Organizimi në Bashkinë Lezhë për çështjet e rinisë dhe dokumentave strategjike**

Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve është strukturë përgjegjëse për mirëadministrimin e çdo çështjeje që lidhet me arsimin, rininë dhe sportet. Ajo ka detyrë të hartojë në bashkëpunim me partnerë të tjerë, projekte për zhvillimin e sektorit të arsimit, rinisë dhe

spORTEVE në territorin e Bashkisë Lezhë. Po ashtu është përgjegjëse për mirëadministrimin e çështjeve që lidhen me hartimin e politikave dhe strategjive me qëllim promovimin, krijimin e netëork-ut të aktiviteteve rinore, duke synuar arritjen e standarteve bashkëkohore, në përputhje me ato kombëtare dhe rajonale në infrastrukturë në ambiente rinore në qytet, me qëllim arritjen e objektivave të saj strategjike dhe përmbushjen e rezultateve të kërkuara nga kjo njësi organizative. Kjo njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e PSVR. Drejtoria përbëhet nga Sektori i Arsimit dhe Rinisë dhe Sektori i Sportit.<sup>13</sup>

Ndërkohë Drejtoria e Projekteve Strategjike, Evropes, Migracionit, Diaspores, Komunikimit dhe Transparencës është përgjegjëse për hartimin e strategjive për zhvillimin afatshkurtër e afatmesëm në territorin e qytetit, në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit dhe në bashkëpunim me drejtoritë e sektorët e tjere në aparat si dhe të monitorojë realizimin e detyrave për implementimin e planëve dhe strategjive të zhvillimit. Kjo Drejtori ka rol kryesor në procesin e monitorimit të PSVR-së.

### ***Profili Demografik i të Rinjve/Projeksioni i Popullsisë 2021-2031***

Popullsia e Shqipërisë ka ardhur duke u zvogëluar që nga viti 2001, megjithëse jo të gjitha qarqet kanë ndjekur këtë prirje. Popullsia mesatare e Shqipërisë për vitin 2021 u pakësua nga 2.837.849 banorë në 2.811.666 banorë.<sup>14</sup> Në nivel kombëtar, numri i lindjeve në vitin 2021 është 27.211 lindje. Raporti gjinor në lindje është 108, që tregon se për çdo 100 vajza të lindura, lindin 108 djem. Ky raport është më i lartë se raporti natyral, i cili është 105. Në vlera absolute, rënia e numrit të lindjeve krahasuar me vitin 2020 është 864 lindje. Për lindjet djem kemi një rënie prej 2,7 %, ndërsa për lindjet vajza rënia është 3,5 %. Lindshmëria ka rënë për grup-moshat 20-24 dhe 25-29, ndërsa për grup-moshat më të vjetra ka pësuar rritje të lehtë. Në vitin 2021, mosha mesatare në lindje ishte 29,2 vjeç.<sup>15</sup>

***Sipas Projektionit 2021 – 2031 të INSTAT*** parashikohen ndryshime thelbësore demografike të Shqipërisë në dekadën e ardhshme. Sipas këtyre projeksioneve popullsia shqiptare do të përjetojë ulje të numrit të lindjeve dhe shtesa e saj natyrore do të jetë e barabartë me zero. Këto parashikime projektojnë ndryshime edhe për grupmoshat 15 – 29 vjeç që i përkasin rinisë, siç paraqiten në Tabelën 4 më poshtë. Siç vihet re nga tabela, grupmosha 15-29 vjeç parashikohet të ketë një trend rënie në periudhën 2026– 2031 në 13.8% nga **536,188 në 461,944 të rinj të moshës 15-29 vjeç**, kjo e lidhur me një serë faktorësh demografikë dhe

---

<sup>13</sup> Bashkia Lezhë, Informacion mbi organizimin në Bashkinë Lezhë, <https://lezha.gov.al/drejtoria-e-arsimit-rinise-dhe-sporteve/>

<sup>14</sup> INSTAT (2022) Vjetari Statistikor Rajonal, faqe 56, [www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)

<sup>15</sup> INSTAT (2022) Burra dhe Gra 2022, faqe 14, [www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)

sociale. Kështu për Qarkun Lezhë parashikohet që rinia (15 vjec-29 vjec) të ketë një rënie prej 13% nga **21,698 në vitin 2026** në **18,885 në vitin 2031**.<sup>16</sup>

(Tabela nr. 4) Projektioni demografik i rinisë Qarku i Lezhës

Projektion grup-mosha 15-29 vjec					
Qarku Lezhe 2026	Total 2026	% nga projektioni kombetar	Qarku Lezhe 2031	Total 2031	% nga projektioni kombetar
21,698	536,188	4%	18,885	461,944	4.1%

Burimi: INSTAT (përpunim i të dhënave bërë nga draftuesit e PSVR-së)

### **Hapësirat e sigurta dhe infrastruktura Rinore**

Hapësirat rinore janë hapësira ku të rinjtë mblidhen, angazhohen në veprimtari që i përshtaten nevojave të tyre. Sipas Ligjit 79/2019 'Për rininë', "Hapësirë rinore e sigurt" është çdo hapësirë ku ushtrojnë veprimtari të rinjtë dhe që plotësojnë standardet e përcaktuara në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Në rastin e të rinjve me aftësi të kufizuara, këto hapësira duhet të zbatojnë elementet e përshtatjes së arsyeshme, në përputhje me shkallën dhe llojin e aftësisë së kufizuar. Ndërkohë "Infrastrukturë rinore" përkufizohet si një hapësirë fizike, tokë, ndërtesë apo pjesë ndërtese e projektuar dhe e planifikuar veçanërisht për të rinjtë dhe veprimtaritë rinore.<sup>17</sup>

Disa nga hapësirat publike të cilat përdoren për realizimin e aktiviteteve në qytetin e Lezhës janë Sheshi "Gjergj Kastrioti", i cili ka standarte të larta dhe nxë për afërsisht 5000-6000 persona, si dhe shëtitorja e lumit Drin. Në zonën e Shëngjinit aktivitetet organizohen tek sheshi Ëilson, i cili ka standarte të larta, me kapacitet deri në 2000 persona. Aktivitete të tjera organizohen po ashtu dhe tek 'Rana e Hedhun' apo Porti dhe Tuneli.

Për sa i përket infrastrukturës rekreative ofrohen dhe ambiente që përdoren për aktivitete të të rinjve siç janë "Qendra Rinore Lezhë", Pallati i Kulturës "Dede Ndue Lazri", 'Biblioteka Publike', 'Qendra Kulturore e Fëmijëve'

<sup>16</sup>INSTAT, Projektionet demografike 2021-2030, <https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/projektionet/#tab3>

<sup>17</sup> Ligji 79/2019 'Për rininë', neni 3/c, ç.



**Qendra Rinore Lezhë** ofron për të rinjtë dhe të rejtat ambientet e rikonstruara me 6 hapësira të ndara në :

- Biblioteka e cila shërben për të rinjtë si hapësirë e qetë për lexim dhe studim dhe cila ofron qasje në libra, revista dhe materiale të ndryshme të shkruara.
- Salla e teknologjisë e cila shërben për të siguruar qasje në internet, aplikacione kompjuterike dhe burime të tjera digjitale. Ajo ofron mundësi për studim, komunikim dhe përdorim të teknologjisë për qëllime të ndryshme si dizjan, grafik, programim etj.
- Këndi i lojrave është një hapësirë ku të rinjtë mund të luajnë lojëra të ndryshme si lojëra të bordit, ping pong etj.
- Kinemaja e cila shërben si një hapësirë për të ofruar argëtim, qasje në artin flimik dhe histori, si dhe për të krijuar një ambient social ku të rinjtë mund të shkojnë për të parë filmat sëbashku.
- Këndi i kreativitetit shërben si një hapësirë ku të rinjtë mund të shprehin dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre kreative nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme artistike dhe krijuese. Këtu të rinjtë mund të pikturojnë, të shkruajnë, të dizajnojnë ose të bëjnë punë dore.
- Salla e konferencave shërben si një hapësirë e organizuar për të mbajtur takime, prezantime, trajnime. Ajo ofron një ambient profesional për diskutime, prezantime duke qenë e pajisur me teknologji audiovizuale për të lehtësuar komunikimin dhe prezantimin e informacionit për pjesëmarrësit.

### **Pallati i kulturës**

- Salla e teatrit në të cilën organizohen koncerte, teatër, evente kreative, takime të komunitetit.
- Salla e kinemasë, në të cilën organizohen dhënie filmash, koncerte, pasdite tematike, takime rinore dhe të komunitetit.
- Galleria e arteve e cila ofron vlerat dhe talentet rinore për artet pamore.
- Salla e Baletit i afrohet rinisë dhe komunitetit për edukimin koreografik.
- Salla e baletit ju afrohet rinisë dhe komunitetit për edukimin koreografik.
- Pavioni i kostumografisë ju afrohet rinisë dhe komunitetit për promovimin edhe edukimin me trashëgiminë kulturore.
- Salla e Ansambllit Qiftelia ju afrohet të rinjve dhe komunitetit për prova muzikore, minikoncerte, pasdite tematike dhe edukim artistik për fëmijet dhe rininë.
- Salla e vales popullore ju afrohet fëmijëve, të rinjve dhe komunitetit për edukim artistiko kulturor, takime, pasdite tematike, mbrëmje muzikore poetike dhe kulturore.

**Biblioteka** ofron për të rinjtë dhe të rejtat ambientet e rikonstruara, përkatësisht 4 sallat e leximit në një koncept të ri, dy ballkonet anësore të cilat do shërbejnë për ekspozita,

promovime libri, shfaqje dokumentare dhe filma, një ambient kafe si dhe një sallë leximi në arkivin e objektit dhe ambientin e lulishtes para bibliotekës.

**Qendra Kulturore e Fëmijëve "Gjergji Laca"** është një tjetër ambienti cili shfrytëzohet nga të rinjtë për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme sociale-kulturore.

Përsa i përket hapësirave dhe infrastrukturës sportive, palestrat e shkollave përdoren për aktivitete sportive pas orarit mësimor, përkatësisht si më poshtë:

- Palestra e shkollës "Nënë Tereza"
- Palestra e shkollës "Hydajet Lezha"
- Palestra e shkollës "Besëlidhja"
- Palestra e shkollës "At Zef Pllumi"

Gjithashtu Stadiumi "Besëlidhja" shfrytëzohet për aktivitete në funksion të disiplinave të ndryshme sportive.

### ***Politikat sociale***

Për sa i përket politikave sociale, të rinjtë mbështeten nga tre skema/politika kryesore si skema e ndihmës ekonomike dhe skema e ndihmës sociale për personat me aftësi të kufizuar, politikat e strehimit social.

Bazuar në skemën e ndihmës ekonomike, për vitin 2022 janë trajtuar gjithsej 7 persona me statusin e jetimit, të ndara sipas gjinive, përkatësisht: 6 meshkuj e 1 femër. Po ashtu aktualisht ofrohet mbështetje me pagesë për personat me aftësi të kufizuara, përkatësisht për 163 persona si dhe 11 persona si invalid pune të rinj deri në moshën 30 vjeç.

Lidhur me strehimin social, Bashkia Lezhë ka në zbatim dy programe të strehimit social, konkretisht: Programi i Banesave me Kosto të Ulët dhe Programi i Subvencionimit të Qirasë. Për të dyja këto programe, Bashkia Lezhë i ka dhënë prioritet kategorisë së çifteve të reja në sistemin e pikëzimit. Nga Programi i Banesave me Kosto të Ulët, konkretisht nga viti 2020, janë 13 familje përfituese të kategorisë "çifte të reja".<sup>18</sup>

---

<sup>18</sup> Bashkia Lezhë, 'Përgjigje shkresës' nr. 2881/1 Prot. date 28.03.2023

### **Aksesi në Arsim dhe Infrastruktura Arsimore**

Kompetencat e BL-së në fushën e arsimit janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 69/2012 të ndryshuar, 'Për sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë' si dhe në Ligjin nr. 139/ 2015 për "Vetëqeverisjen Vendore". Sipas këtyre ligjeve, NJVV ja është përgjegjëse për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në institucionet arsimore parauniversitare publike.

Numri i nxënësve të arsimit parauniversitar ka një ulje të vazhdueshme në vlerë absolute në nivel kombëtar. Në vitin shkollor 2021- 22, u regjistruan në arsimin parauniversitar 453.989 nxënës dhe fëmijë, duke shënuar një ulje prej 2,5%, krahasuar me vitin shkollor 2020-21 dhe 12,8% krahasuar me vitin shkollor 2017-2018. Rënia e numrit të nxënësve në vlerë absolute, ndjek rënien e popullsisë së grupmoshës që i përket arsimit parauniversitar dhe reflektohet edhe për qarkun Lezhë.

Në arsimin e mesëm privat ndjekin studimet 13,4% e nxënësve të arsimit të mesëm gjithsej. Sidoqoftë, vërehen ndryshime të mëdha ndërmjet qarqeve Vlorë, Fier, Lezhë, Shkodër dhe Tiranë, të cilat kanë përqindjen më të lartë të arsimit të mesëm privat.<sup>19</sup>

Arsimi profesional ka qenë përparësi vitet e fundit, duke u parë si një mundësi për të plotësuar nevojën e vazhdueshme për punonjës të specializuar në profesione të ndryshme. Të regjistruarit e arsimit të mesëm profesional për vitin 2021-22 përbëjnë 17,7% të numrit të përgjithshëm të të regjistruarve në arsimin e mesëm, ndërsa në vitin 2017-18 përbënin 17,2%.

Rritjen më të lartë në përqindjen që zë arsimi profesional në këtë vit shkollor, krahasuar me vitin 2017-18, e kanë qarqet Lezhë dhe Shkodër me respektivisht me 4,7 dhe 2,7 pikë përqindje. Prefekturat Fier, Gjirokastër dhe Kukës, patën një ulje prej respektivisht 2,6, 2,0 dhe 1,6 pikë përqindje. Prefekturat e tjera patën një ndryshim prej më pak se 1,4 pikë përqindje.<sup>20</sup>

Si më poshtë gjenden të dhëna statistikore mbi arsimin e mesëm të lartë.

Tabela 6<sup>21</sup>

---

<sup>19</sup> INSTAT (2022) Vjetari Statistikor Rajonal, faqe 120, [www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)

<sup>20</sup> Ibid, fq.121

<sup>21</sup> Bashkia Lezhë, Planifikimi Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, Të dhëna bazë mbi programin 09230

Të Përgjithshme		2018	2019	2020	2021	2022
Numri i nxënësve të regjistruar në sistemin e mesëm		2,043	1,936	1,793	1,746	1,580
Vajza të regjistruar në sistemin e mesëm (klasa 10-12)		1,090	1,000	939	907	791
Djem të regjistruar në sistemin e mesëm (klasa 10-12)		953	936	854	839	789
Numri i nxënësve të rregjistruar në klasën e 10		626	657	616	520	739
Numri i nxënësve vajza të rregjistruar në klasën e 10		284	345	301	244	308
Numri i nxënësve djem të rregjistruar në klasën e 10		342	312	315	276	431
Numri i nxënësve që përfundojnë sistemin bazë (9-vjeçar)		938	871	730	739	722
Numri i nxënësve vajza që përfundojnë sistemin bazë (9-vj.)		473	410	338	308	355
Numri i nxënësve djem që përfundojnë sistemin bazë (9-vj.)		465	461	390	431	367
Nr. mësuesve në sistemin e arsimit të mesëm (viti 10-12)		167	167	161	158	163
Vajza-gra		118	118	116	113	113
Burra-djem		49	49	45	45	50
Numri klasave në sistemin e arsimit të mesëm		80	80	78	75	75
Shpenzimet gjithsej programit mijë lekë		97,322.6	105,932.1	89,048.7	81,557.1	218,016.3
Numri i godinave në gjendje jo të mire		3	3	2	0	0
Numri i godinave në gjendje të mire		5	5	5	5	4
Numri i godinave në gjendje shumë të mire		4	4	4	6	7
Numri i aktiviteteve me të rinjtë		0	0	0	2	9
Numri i pjesëmarrës në aktivitete		3,026	2,953	2,775	2,694	2,498
Numri i pjesëmarrës vajza në aktivitete		1,523	1,459	1,392	1,319	1,273
Numri i nxënësve djem (14-19 vjeç) pjesëmarrës në aktivitete.		1,503	1,494	1,392	1,319	1,273
Shpenzime për aktivitete me të rinjtë.		0	0	0	500	1,159
Numri i nxënësve të akomoduar në konvikte		47	49	52	34	33
Numri i vajzave		21	21	21	13	11
Numri i djemve		26	28	31	21	22
Numri i dhomave të konvikteve		21	21	21	6	6
Numri i konvikteve funksionale në bashki		1	1	1	1	1

### **Përfaqësimi dhe Pjesëmarrja**

Pjesëmarrja e pakët e të rinjve në vendimmarrje ende vazhdon të jetë një çështje delikate që shpesh është jo vetëm indikator i një demokracie fiktive, por sjell pasoja të konsiderueshme në jetën publike dhe bën që reformat të mbeten në nivel teorik pa gjetur mbështetje për zbatim. PSVR-ja ka si qëllim jo vetëm ruajtjen dhe forcimin e infrastrukturës ekzistuese për mbështetjen e të rinjve për të qenë pjesë aktive në proceset dhe vendimmarrjet demokratike por edhe forcimin e strukturave dhe kapaciteteve të organizatave dhe grupeve rinore.

Në nga organet e legjitimuar nëpërmjet Ligjit 'Për Rininë' është Këshilli vendor i rinisë si organ këshillimor pranë NJVV-ve, që funksionon pranë kryetarit të bashkisë. Ky është organ që siguron angazhim dhe përfaqësim të të rinjve me kompetencat si mëposhtme:

- këshillon për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;
- vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;
- propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave

të të rinjve në territorin ku veprojnë.<sup>22</sup>

<sup>22</sup> Ligji për Rininë 79/2019, Neni 10,

Këshilli Vendor i Rinisë pranë Bashkisë Lezhë është ngritur bazuar në aplikimin e hapur të thirrjes publike të datës 15.7.2022 sipas Vendimit Nr. 44, datë 27.04.2022 të Këshillit Bashkiak *“Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit vendor të rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit tij”*. Ky Këshill është i përbërë nga:

1. Kryetar : Z.Pjerin Ndreu Kryetari i Bashkisë Lezhë
2. Anëtar: Klodjana Rakaj Përfaqësuese nga Drejtoria Arsimit Rinisë dhe Sporteve

Dhe përfaqësues nga Organizatat Rinore dhe të rinj aktiv:

1. Anëtar: Vasilika Laska
2. Anëtar: Erion Brahim
3. Anëtar: Fabjola Ndoj
4. Anëtar: Kejvin Kola.<sup>23</sup>

Në pyetësin e adresuar të rinjve, pyetjes mbi informimin dhe familjarizimin e të anketuarve me të drejtat e të rinjve për pjesëmarrje në vendimmarrje, 21 prej të anketuarve i janë përgjigjur se *“i njohin dhe i përdorin këto të drejta/instrumente”*, konkretisht 41.2%. Dymbëdhjetë ose 23.5% prej tyre shprehën se *“i njohin por nuk i përdorin këto të drejta”*, dhe dymbëdhjetë të tjerë janë përgjigjur me *“Disi”*. Tre të anketuar që përbëjnë 5.9% janë shprehur që *“kanë dëgjuar për këto të drejta por kanë nevojë për më tepër informacion” dhe tre janë shprehur me “jo”*.

Edhe pse ky rezultat konsiderohet pozitiv, duhet të vëmë në pah se të rinjtë të cilët kanë tendencë për tu përgjigjur pyetësorëve janë ata të cilët kanë qasje aktive si dhe janë përdorues të mirë të instrumentave të ndryshëm elektronikë. Ndaj në këtë prizëm duhet të konsiderohet me rezervë përgjithësimi i këtij rezultati për të rinjtë e Bashkisë Lezhë. Masat në PSVR nën këtë objektiv do të targetojnë së pari kategorinë e të rinjve apatikë të cilët janë pasivë, nuk i njohin të drejtat e tyre duke synuar informimin, sensibilizimin dhe përfshirjen e tyre procese vendimmarrëse, konsultuese.

### **Politikat Ekonomike Rinore**

Gjatë viteve të fundit rritja ekonomike dhe nivelet e punësimit nuk kanë patur një vijë të njëtrajtshme lineare, por kanë pësuar ulje dhe ngritje në mënyrë të vazhdueshme. Punësimi i të rinjve edhe pse janë pjesa më produktive e shoqërisë shqiptare mbetet sërish një sfidë

---

<sup>23</sup> Vendim i Kryetarit të Bashkisë Lezhë, nr. 515 date 4.12.2022 ‘Emërimin e anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë’

me të cilën duhet të përballen qeveria qendrore dhe vendore, si dhe organizmat e tjerë me fokus rininë.

Të dhënat e anketës së forcave të punës nuk mundësojnë tregues sipas 61 bashkive të përcaktuara nga ndarja administrative. Duke filluar nga viti 2019, janë kryer disa vlerësime lidhur me dy bashkitë më të mëdha në vend, Tiranës dhe Durrësit, për sa u përket treguesve kryesorë: shkallës së punësimit, shkallës së papunësisë dhe shkallës së pjesëmarrjes në forcat e punës. Në vitin 2021, ka rreth 163 mijë njerëz të papunë në Shqipëri, që është e barabartë me 11,5% të forcës totale të punës. Shkalla më e lartë e papunësisë është regjistruar në Lezhë (22,6%), Vlorë (19,5%) dhe Durrës (16.1%). Po ashtu Qarku Lezhë së bashku me atë Shkodër sipas raportit të INSTAT për vitin 2021 kishin pagën më të ulët (afërsisht 46.482 lekë dhe 46.632 lekë) ndërkohë që paga mesatare mujore në Shqipëri në vitin 2021 ishte 57.191 lekë. Krahasuar me mesataren mujore në nivel kombëtar, qarku i Tiranës ka pagën mesatare mujore më të lartë me 11,8%, ndërsa qarku i Lezhës ka pagën më të ulët 17,7%.<sup>24</sup>

Përsa i përket Programit të Nxitjes së Punësimit, Bashkia Lezhë nuk administron program apo politikë të mirëfilltë punësimi (as për të rinjtë), por bashkëpunon ngushtësisht me Zyrën Rajonale të Punësimit Lezhë për referimin e rasteve të ndryshme.<sup>25</sup> Ndërkohë mungon në Lezhë një qendër formimi profesional në ndihmë të formimit profesional të të rinjve të cilët synojnë tregun e punës.

## 4.2 ANALIZË E PYETËSORIT DHE REZULTATEVE TË TRYEZAVE TË RRUMBULLAKËTA

Ky pyetësor synoi matjen e përceptimit të të rinjve në Bashkinë Lezhë mbi problematikat rinore si dhe sugjerimin e çështjeve që do të dëshironin të adresoheshin në Planin Strategjik Vendor për Rininë të Bashkisë Lezhë. Kjo analizë u mbështet në një kampionim prej 51 personash nga ku janë identifikuar se 74.5% i përkasin gjinisë femër, 19.6% i përkasin gjinisë mashkull dhe 5.9% kanë preferuar të mos deklarohen. Të anketuarit 54.9% banojnë në zonë urbane dhe 45.1% në zonë rurale duke patur përfaqësim të të dy realiteteve.

Të anketuarit janë pyetir lidhur me mbi informimin dhe familjarizimin me të drejtat e të rinjve për pjesëmarrje në vendimmarrje, ku 21 prej të anketuarve i janë përgjigjur se *“i njohin dhe i përdorin këto të drejta/instrumente”*, konkretisht 41.2%. Dymbëdhjetë ose 23.5% prej tyre shprehen se *“i njohin por nuk i përdorin këto të drejta”*, dhe dymbëdhjetë të tjerë janë përgjigjur me *“Disi”*. Tre të anketuar që përbëjnë 5.9% janë shprehur që *“kanë*

<sup>24</sup> INSTAT (2022) Vjetari Statistikor Rajonal, faqe 76, [www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)

<sup>25</sup> Bashkia Lezhë, ‘Përgjigje shkresës’ nr. 2881/1 Prot. date 28.03.2023


dëgjuar për këto të drejta por kanë nevojë për më tepër informacion” dhe tre janë shprehur me “jo”.

Së seksionin e dytë të pyetjeve titulluar “Përceptimi i situatës aktuale” u kërkua nga të anketuarit të zgjedhin deri në 3 alternativa që përmbajnë çështje kryesore me të cilat përballeshin të rinjtë e Bashkisë Lezhë, të cilat ata konsiderojnë si më problematike. Dy çështjet që morën më shumë vëmendje dhe u cilësuan si më problematike sipas pjesëmarrësve janë: papunësia rinore me 29 klikime (56.9%) dhe ikja e trurit/emigrimi i të rinjve me 28 klikime (54.9%). Problematika e rradhës në të cilën anketuesit u fokusuan më shumë ishte situata ekonomike me 20 klikime (39.2%). Çështje të tjera problematike u cilësuan korrupsioni me 14 klikime (27.5%), mungesa e infrastrukturës/hapësirave rinore me 13 klikime (25.5%), mungesa e aktiviteteve që mbështesin potencialin rinor me 12 klikime (23.5%), mungesa e arsimit cilësor me 9 klikime (17.6%).

Problemet me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mungesa e mundësive për të përfshirë të rinjtë në vendimmarrje dhe mungesa e hapësirave dhe infrastrukturave sportive morën secila nga 5 klikime (9.8%). Katër të anketuar (7.8%) cilësuan si problematike: mungesën e hapësirave të gjelbërta dhe katër të tjerë mungesën e mundësive për edukim joformal. Një i anketuar gjykon si problematike problemet mjedisore ku përfshihen dhe efektet e ndryshimeve klimatike. Dy alternativat që nuk morën asnjë klikim dhe sipas pyetësorit dalin si më pak problematike në krahasim me përgjigjet e tjera janë: *mungesa e mbështetjes të personave me aftësi të kufizuara dhe mungesa e shërbimeve të përkujdesit social vendor*.

6-Zgjidhni deri në tre (3) çështje kryesore që ju i konsideroni më problematike me të cilat po përballeshin rinia në Bashkinë Lezhë:

51 responses



Tek pyetja e fundit e pyetësorit, *“Sipas mendimit tuaj cilat çështje janë më të rëndësishmet për tu përfshirë në Planin Strategjik mbi Rininë për Bashkinë Lezhë?”* u morën mendime të ndryshme nga të 51 të anketuarit ku më së shumti dallohen çështje si ‘aktivizimi i rinisë me anë të hapësirave dhe aktiviteteve rinore’, ‘mundësia e të rinjve të jenë pjesë e rëndësishme në vendimmarrje’ për sa ju përket çështjeve rinore dhe problematikat që lidhen me emigrimin e të rinjve si pasojë e papunësisë dhe e mungesës së motivimit dhe mbështetjes.

Në përgjigjet e marra, gjenden gjithashtu të përmendura çështja e korrupsionit dhe mosinformimi mbi mundësitë dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me të rinjtë. Sipas të anketuarëve, dhënia më tepër e informacioneve nga institucionet përkatëse për organizimin e këtyre eventeve apo aktiviteteve do rriste dhe pjesëmarrjen e të rinjve. Për t’u përmendur janë dhe përgjigjet që i japin dritë dhe problemeve si mbështetja financiare që do të ndihmonte në fuqizimin e të rinjve por gjithashtu dhe fokusi që duhet t’i jepet shëndetit mendor. Disa nga përgjigjet më relevante gjenden si vijon:

***‘Sipas mendimit tuaj cilat çështje janë më të rëndësishmet për tu përfshirë në Planin Strategjik mbi Rininë për Bashkinë Lezhë?’***

- Hapësirat rinore dhe emigrimi i të rinjve.
- Përfshirja e të rinjve në politikat që ndikojnë drejtpërdrejt në mirqënien e tyre sociale. Krijimi i hapsirave ku ata mund të ushtrojnë aftësitë e tyre vendimmarrëse, qoftë kjo nëpërmjet konsultimeve, pyetësorëve apo dhe formave të tjera ku të rinjtë mund të paraqesin problematikat që ata hasin por dhe të sugjerojnë mënyra për lehtësimin e zhvillimit të tyre sa më të shëndetshëm e të lehtë për ta.
- Më shumë mundësi për të rinjtë, orientim për arsimim bazuar në nevojat lokale të tregut të punës, promovimi i të rinjve modele pozitive, objektiva dhe mbështetje konkrete për të rinjtë që vijnë nga shtresa me ndihmë ekonomike.
- Shëndeti mendor i të rinjve lezhjanë. Korrupsioni në institucionet shkollore. Mbështetja e të rinjve lezhjanë që ballafaqohen me probleme ekonomike në familje.
- Përfshirje në aktivitetet me potencial rinor. Mundësi të reja për punësim. Përfshirja e të rinjve në vendimmarrje.
- Çështja që mund të ketë më së shumti rëndësi është papunësia rinore dhe mungesa e tregut ku mund të punësohen.
- Informimi i të rinjve për mundësitë që ka bashkia për ta dhe që të rinjtë të jenë fokus i bashkisë edhe në vijim.
- Hapje kursesh profesionale. Atyre që janë të punësuar, rritje page + rritje motivimi në punë.
- Punësimi dhe Integrimi i të rinjve Frenimi i emigrimit Mbështetje financiare dhe sociale për të rinjtë.
- Hapësira të ndryshme ku të rinjtë mund të argetohen. Promovimi i talenteve të reja.



- Korrupsioni qe bëjn disa shkolla (mësues) dhe emigrimi bashke me papunesine.
- Te krijohen grupe të caktuara për mendimin kritik.
- Korrupsioni pasi ka kaluar çdo lloj niveli.
- Të rinjtë të përfshihen në vendimmarrje.
- Të publikohen më shumë informacionet.
- Infrastruktura e shkollave.

Përvec pyetësorit, për mbledhjen e mendimeve dhe sugjerimeve nga të rinjtë në kuadër të hartimit të PSVR-së, organizata “Social Inclusion for Development”, zhvilloi dy tryeza të rumbullakëta në kuadër të projektit “Unë, Bashkia dhe Këshilli Bashkia”. Të rinjve pjesëmarrës ju drejtuan disa pyetje për të identifikuar disa nga problematikat që shqetësojnë të rinjtë e Bashkisë Lezhë.

- Cilat janë të drejtat e të rinjve për pjesëmarrje në vendimmarrje?
- Cilat janë shërbimet që ju mungojnë të rinjve në Lezhë?
- Cilat janë çështjet më problematike me të cilat përballet rinia në Bashkinë Lezhë?
- Për çfarë platformash ka nevojë rinia e Bashkisë Lezhë që të përfshihet në procesin e vendimmarrjes?

Nga përgjigjet e dhëna nga pjesëmarrësit dhe diskutimit të zhvilluar dolën këto rezultate:

### **Tryeza e I-rë**

- 1- Mungesa e infrastrukturës për të ofruar shërbimin e pas shkollës për nxënësit e shkollave të mesme.
- 2- Mungesa e ambienteve rekreative dhe inspiruese për aktivitete artistike.
- 3- Mungesa e një Qendre Publike për formim profesional.
- 4- Mungesa e hapësirave sportive te hapura dhe të mbylluara.
- 5- Mungesa e këshillimit për karrierë për nxënësit e klasave të 9 dhe maturave.
- 6- Mungesa e shërbimeve dhe aktiviteteve rehabilituese për të miturit me precedentë penal.
- 7- Mungesa e kopshteve dhe hapësirave të gjelbërta.
- 8- Mungesa e transportit publik me orare fikse në Njësitë Administrative.
- 9- Mungesa e aksesueshmërisë dhe sinjalistikës për të rinjtë me aftësi të kufizuar në shikim.
- 10- Mungesë e librave të nevojshëm në Bibliotekën e Lezhës.

### **Disa prioritete që Bashkia Lezhë duhet të ketë në fokus:**

- a- Mbështetje për arsimin joformal dhe organizatat rinore civile.

- b- Rritja e numrit të punëtorive, trajnimeve dhe shkollave verore për të rinjtë nga Njësitë Administrative.
- c- Promovimi dhe rritja e numrit të të rinjve që marrin pjesë në arsimit joformal.
- d- Rritja e fondit të bibliotekave dhe numri i bibliotekave dhe dhomave të studimit në qytet dhe Njësi Administrative.
- e- Sigurimi i informacionit dhe mbështetjes për të rinjtë në lidhje me të rinjtë mundësi punësimi dhe vetëpunësimi.
- f- Mbështetja dhe zhvillimi i vullnetarizmit në komunitetin lokal.
- g- Sigurimi i përfitimeve sociale për të rinjtë për të përmirësuar cilësinë e jetës së të rinjve.
- h- Krijimi i kanaleve për komunikim të rregullt ndërmjet të rinjve dhe bashkisë.
- i- Mbështetja dhe promovimi i aktiviteteve të organizatave rinore civile.

Zgjidhjet e mundshme për këto problematika:

- 1- Hapja e një Qendër Këshillimi për Karrierë
- 2- Sigurimi i transportit publik urban ku të paktën gjatë ditës të ketë urban për të lidhur qytetin me njësitë administrative çdo një orë.
- 3- Vendosjen e sinjalistikës rrugore për të rinjtë me aftësi të kufizuar në shikim.
- 4- Hapjen e një Kinemaje Publike dhe Kinema Lëvizëse.
- 5- Krijimin e një qendre sportive të mbylluar për sporte të ndryshme si patinazhi, noti.
- 6- Lobim në strukturat e shtetit për të sjell në Lezhë një filial të Qendrave të Formimit Profesional.
- 7- Sigurimi i qendrave sportive për sporte si vollyeball, basketball.
- 8- Ndërtimi i një Kopshti Botanik.
- 9- Zgjerimi i hapsirave të gjelbërta.
- 10- Krijimi i një qendre IT për zhvillimin e aftësive teknologjike.
- 11- Krijimi i një fondi dedikuar edukimit joformal.

**Tryeza e II-të**

- 1- Mungesa e infrastrukturës për formim profesional për të rinjtë.
- 2- Mungesa e aktiviteteve dhe metodave për zbulimin dhe promovimin e talenteve.
- 3- Mungesa e hapsirave rekreative dhe hapsirave digjitale.
- 4- Mungesa e shpërndarjes dhe perçimit të informacionit tek të rinjtë.
- 5- Mungesa e sallave publike me kompjutëra.
- 6- Mungesa e mirëmbajtjes së hapësirave dhe mjediseve rinore.
- 7- Probleme me menaxhimin urbanistik.
- 8- Probleme me ndërtimin dhe betonizimin e qytetit.
- 9- Mungesë e nxitjes për edukim jo formal.

10- Largim masiv i të rinjve.

Zgjidhjet e mundshme për këto problematika:

- 1- Organizimi i aktiviteteve artistike kulturore me qëllim zbulimin e talenteve të reja dhe perfshirjen e tyre në art.
- 2- Përdorimi i tabelave publike për informim për të mundësuar informimin e të rinjve për aktivitetet rinore që zhvillohen në qytetin e Lezhës.
- 3- Krijimi i një salle publike me kompjutera për nxitjen e aftësive digjitale për të rinjtë.
- 4- Krijimi i lehtësirave dhe akseseve për organizatat e shoqërisë civile për të përcjellë infomacionin mbi aktivitetet rinore që ato do të zhvillojnë.
- 5- Garantimi i ekzistencës së hapësirave rinore dhe mirëmbajtjes së tyre.
- 6- Më shumë nxitje të edukimit jo formal.
- 7- Krijimi i urave të bashkëpunimit mes OJF dhe institucioneve arsimore.
- 8- Krijimi i lehtësirave në akses tek hapësirat publike në pronësi të Bashkisë Lezhë.

## 5. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT

### 5.1 VIZIONI

Vizioni i PSVR-së është *'Vendosja e rinisë në fokus të jetës aktive'*. Në këtë frymë, PSVR synon të nxisë aktivizmin rinor dhe rritjen e kapaciteteve për të rinjtë në mënyrë që ata të kenë më shumë mundësi dhe hapësira në të ardhmen. Nën këtë vizion, PSVR projektin krijimin e kushteve dhe një mjedisi të sigurt për një rini aktive dhe të barabartë në të gjitha fushat e jetës dhe me status të konsoliduar për të ardhmen e tyre. Prioritet është përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së jetës së të rinjve dhe forcimi i statusit të tyre, përmes zhvillimit të më shumë mundësive në edukim, punësim, kulturë dhe sigurimin e mundësive për pjesëmarrje të të rinjve në shoqëri dhe vendimmarrje.

PSVR frymëzohet po ashtu dhe nga vizioni kombëtar dhe atë evropian mbi angazhimin qytetar, forcimin ekonomik, mbrojtjen sociale dhe zhvillimin kulturor të të rinjve. Përparësitë e angazhimit strategjik synojnë shfrytëzimin optimal të burimeve në dispozicion dhe një bashkërendim të punës jo vetëm ndërmjet strukturave të BL-së që kontribuojnë në zhvillimin e rinisë por edhe bashkërendimin e punës së institucioneve në të gjitha nivelet e qeverisjes. Në fokus është dhe krijimi i sinergjive nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë civile, organizatave ndërkombëtare dhe bizneseve. Bazuar gjithashtu në qëllimin dhe objektivat e *'Strategjisë Kombëtare për Rininë 2022-2029'* dhe *"Strategjisë Evropiane për të Rinjtë 2019-2027"*, strategjia vendore për të rinjtë synon që të bashkojë të rinjtë për ndërtimin e një qyteti pa barriera.

Zhvillimi i bazuar mbi pikat e forta dhe procesin e vizionimit është shumë më avantazhues sesa një plan zhvillimi bazuar mbi probleme të cilat fokusojnë vëmendjen drejt zgjidhjes duke humbur panoramën e përgjithshme. Politikat, planet dhe projektet për rininë nuk mund të hartohen dhe aq më tepër të zbatohen pa marrë në konsideratë të gjitha aspektet sociale, ekonomike dhe rekreative.

Pesë shtyllat kryesore mbi të cilat bazohet PSVR janë në harmoni me kaudrin ligjor gje dokumentat strategjike në nivel qendror, vendor dhe evropian për mbështetjen e zhvillimit të potencialit rinor. Në evidentimin e këtyre shtyllave rol të rëndësishëm patën analiza e situatës aktuale në fusha të cilat janë nën kompetencë të Bashkisë Lezhë, si dhe sugjerimet/rekomandime nga të rinjtë e BL-së duke formuluar këto objektiva:

- ❖ **1. Hapësirat dhe infrastruktura rinore:** Ky objektivi do të realizohet nëpërmjet investimeve konkrete në infrastrukturën arsimore në të gjithë territorin e BL-së si dhe në hapësira dhe infrastrukturë me destinacion zhvillimin e aktiviteteve rinore.

- ❖ **2. Edukimi jo-formal i të rinjve.** Ky objektivi do të realizohet nëpërmjet organizimit të veprimtarive për të rinjtë jashtë sistemit arsimor parauniversitar, nëpërmjet bashkëpunimit me organizatat rinore ku ata zhvillojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre kryesisht në fushën e mjedisit, kulturës dhe artit, mbrojtjen e trashëgimisë historike-kulturore, turizmit dhe përfshirjen në jetën sportive.
  
- ❖ **3. Përfaqësimi, pjesëmarrja dhe integrimi në BE.** Ky objektivi do të realizohet nëpërmjet zbatimit të projekteve konkrete lidhur me rritjen e përfaqësimit të të rinjve në proceset e vendimmarrjes në BL, ndërgjegjësimin dhe edukimin e të rinjve për pjesëmarrjen në proceset zgjedhore si e drejtë demokratike e shprehjes së vullnetit duke projektuar kështu rininë si aleatin e saj më të mirë në bashkëqeverisjen e saj.
  
- ❖ **4. Siguria Sociale për të rinjtë.** Ky objektivi do të garantojë ngritjen dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve të përkujdesit social vendor dhe fuqizimin e bashkëpunimit të BL-së me organizatat rinore dhe organizatat që punojnë edhe për rininë për parandalimin e fenomeneve të rrezikshme sociale.
  
- ❖ **5. Mbështetja financiare dhe nxitja e punësimit.** Nën këtë objektivi parashikohen politika/projekte dhe aktivitete të cilat prodhojnë skema dhe mekanizma nxitës dhe lehtësues për të rinjtë që dëshirojnë të hapin biznesin e tyre (start-up) ose të zhvillojnë biznesin ekzistues, si dhe përgatitja e tyre për në tregun e punës.

## 5.2 OBJEKTIVAT STRATEGJIKE, PROGRAMET DHE INDIKATORËT

Pjesë e rëndësishme e PSVR-së është identifikimi i projekteve/aktiviteteve në funksion të përmbushjes së objektivave strategjike. Projektet dhe aktivitetet janë të organizuara në programe. Disa prej tyre janë produkte të cilat janë tashmë të parashikuara në PBA 2023-2025. Kjo metodologji synon të përmirësojë menaxhimin financiar të BL-së në funksion të përmbushjes së objektivave strategjike dhe vizionit të përcaktuar nga ky dokument. Gjithashtu kjo qasje lehtëson identifikimin e strukturave përgjegjëse dhe indikatorëve për secilin projekt, krijon besueshmëri tek qytetarët apo donatorët potencial, duke pohuar që financimet e këtyre projekteve janë pjesë e një skeme zhvillimi gjithëpërfshirëse për BL.

Projektet dhe aktivitetet, përveç atyre të cilat janë tashmë të planifikuara në PBA, janë mbështetur në kuadrin politik/strategjik të trajtuar si më sipër si dhe sugjerimet e ardhura nga procesi i konsultimit publik.

Për të gjitha produktet e pritshme të cilat nuk janë të buxhetura, është e pritshme që të jenë në fokus të proceseve të ardhshme të rishikimit të buxhetit dhe hartimit të PBA deri në vitin 2027. Po ashtu do të synohet të arrihen nëpërmjet bashkëpunimit me donatorë të ndryshëm kombëtar dhe ndërkombëtar, grante të fituara nëpërmjet projekteve që Bashkia Lezhë mund të fitojë si dhe në bashkëpunim të ngushtë me “Organizatrat rinore” dhe/apo “Organizatrat për të rinjtë”, të cilat janë partnerë kyç në realizimin me sukses të PSVR-së.

### ***Objektivi strategjik 1. Hapësirat dhe infrastruktura rinore***

Hapësirat dhe infrastruktura rinore është një prioritet i domosdoshëm për zhvillimin socio-ekonomik të të rinjve. Ky objektivi do të realizohet nëpërmjet investimeve konkrete në hapësira dhe infrastrukturë me destinacion zhvillimin e aktiviteteve rinore bazuar në dy programe: *Infrastruktura arsimore dhe Hapësira dhe Infrastruktura rekreative.*

**1-HAPËSIRAT DHE INFRASTRUKTURA RINORE**

PROGRAME	PROJEKTE/AKTIVITETE	INDIKATORE	TARGET PËR INDIKATOR	REZULTATE	Planifikuar në PBA 2023-2025
<p><b>Infrastruktura arsimore</b></p>	<p>1. Ndërtimi i shkollave të ciklit parauniversitar me standarde aksesueshmërie;                  2. Rehabilitimi i shkollave të ciklit parauniversitar me standarde aksesueshmërie;                  3. Krijimi i laboratorëve funksionalë në institucionet arsimore dhe funksionimi i atyre ekzistues;                  4. Ndërtimi/rehabilitime të palestrave dhe terreneve sportive në shkolla me standarde aksesueshmërie;;                  5. Pajisja e shkollave me sistemin e sigurisë (kamera, sistem alarmi, masat mbrojtëse kundër zjarrit etj.);                  6. Ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme mbrojtëse për shkollat të cilat hyrjen e kanë buzë rrugës (polici i shtrirë, kangjella, sinjalistika vertikale dhe horizontale).                  7. Mirëmbajtja, përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve në Konviktin e Shkollës Profesionale.                  8. Buxheti i dedikuar për infrastrukturë të përshtatshme për shfrytëzimin e TIK-ut në shkolla dhe mirëmbajtja e saj.(SKA)</p>	<p>1. Numri i shkollave të reja me standarde të aksesueshmërisë;                  2. Numri i shkollave të rehabilituara me standarde të aksesueshmërisë;                  3. Numri i laboratorëve të ndërtuar/ rehabilituar sipas standardeve të aksesueshmërisë;                  4. Numri i palestrave/terreneve sportive të rehabilituara apo ndërtuara me standarde të aksesueshmërisë;                  5. Numri i shkollave të pajisura me sistemet e sigurisë;                  6. Numri i shkollave të pajisura me infrastrukturë mbrojtëse.                  7. % e rritjes së numrit të nxënësve që akomodohen në konvikt.                  7.1 % e rritjes së numrit të dhomave në konvikt.                  8. Buxheti i alokuar për infrastrukturë të përshtatshme për shfrytëzimin e TIK-ut në shkolla dhe mirëmbajtja e saj.</p>		<p>- Mbulim më i mirë i hapësirave urbane dhe rurale me shkolla që plotësojnë standardet e aksesueshmërisë;                  - Përmirësim i cilësisë dhe kushteve të procesit mësimor;                  - Përmirësim i rezultateve shkollore të nxënësve;                  - Rritja e sigurisë së nxënësve dhe mësuesve;                  - Përmirësimi i jetës së nxenesve jashtë ambienteve arsimore me impakt të ndjeshëm në gjendjen psikologjike, sociale dhe shoqërore;                  - Objekte shërbimi dhe sportive funksionale dhe me standarde për nxenesit në shkolla;                  - Rritja e nxënësve që frekuentojnë arsimin e mesëm publik.                  -Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve dhe tërheqja e më shumë nxënësve në Konviktin e Shkollës Profesionale.                  -Krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për shfrytëzimin e TIK-ut në shkolla dhe mirëmbajtja e saj.</p>	<p><b>Programi Arsimit Mesëm i Pergjithshëm 09230:</b>                  1-Ndërtimi i Palestrës së SHM Bashkuar Zejman në vitin 2025.                  2. Ndërtimi i objekteve sportive në shkolla.                  3. Përmirësimi i standardeve të shërbimeve për mirëmbajtjen e objekteve shkollore.                  4- Mirëmbajtja, përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve dhe tërheqja e më shumë nxënësve në Konviktin e Shkollës Profesionale. Rritja e numrit të nxënësve që akomodohen në konvikt. (% e rritjes së numrit të nxënësve që akomodohen në konvikt femra/meshkuj. 4.1 % e rritjes së numrit të dhomave në konvikt.)</p>

**1-HAPËSIRAT DHE INFRASTRUKTURA RINORE**

PROGRAME	PROJEKTE/AKTIVITETE	INDIKATORE	TARGET PËR INDIKATOR	REZULTATE	Planifikuar në PBA 2023-2025
<p><b>Hapësira dhe Infrastruktura rekreative</b></p>	<p>1- Krijimi i mjediseve multifunktionale (biblioteka, kënde informacioni etj.) me standarde aksesueshmerie të shkollave;.                  2- Rehabilitimi/ ndërtimi i bibliotekave në NJA;                  3- Ndërtimi dhe rehabilitimi i qendrave/terreneve sportive publike si përshembull qendër sportive e mbyllur për sporte si patinazhi, noti/ apo sporte si volleyball, basketball.                  4- Ngritja e qendrave rinore ne Njësitë Administrative.                  5-Ndërtimi i parqeve për fëmijë dhe të rinj, parqeve me dorë;                  6- Informatizim i Bibliotekës së qytetit Lezhë;                  7-Shtimi i titujve të librave të rinj në biblioteka ekzistuese.                  8-Hapjen e një Kinemaje Publike dhe/ose Kinemaje Lëvizëse.</p>	<p>1- Numri i bibliotekave të ndërtuara apo rehabilituara;                  2- Numri i terreneve sportive publike të ndërtuara apo rehabilituara;                  3- Numri i qendrave rinore ne Njësitë Administrative;                  4- Numri i qendrave rinore ne Njësitë Administrative të BL-së.                  5-Numri i parqeve të ndërtuara për fëmijë dhe të rinj, parqeve me dorë;                  6-Bibliotekë e informatizuar;                  7-Numër librash të rinj të shtuar në bibliotekat ekzistuese.                  8-Kinema publike/Kinema Lëvizëse e hapur.</p>		<p>- Një aset më shumë, një mjedis ku ndërveprojnë të rinjtë ku ndërlihet më së miri teknologjia dhe arti sic jane bibliotekat, qendrat rinore apo qendrat multifunktionale, kinema publike/lëvizëse.                  - Rritja e frekuentimit të bibliotekave.                  -Hapësira të tjera për fëmijët dhe të rinjtë për aktivitetet jashtë, si parqet, terrenet sportive.</p>	<p><b>Programi Sport dhe argetim 08130:</b>                  1-Ndërtim i parkut të lojërave për fëmijë dhe të rinjtë në vitin 2024-                  2-Ndërtimi i parkut të lojërave me dorë, në vitin 2023;                  3-Ndërtimi i parkut të lojërave me dorë në vitin 2025;</p> <p><b>Programi Trashëgimia Kulturore, eventet artistike dhe kulturore 08220:</b>                  Informatizim i bibliotekës së qytetit në vitin 2023 dhe pasurim me tituj të rinj.</p>



## **Objektivi strategjik 2. Edukimi jo-formal i të rinjve**

Ky objektivi do të realizohet nëpërmjet organizimit të veprimtarive për të rinjtë jashtë sistemit arsimor parauniversitar, nëpërmjet bashkëpunimit me organizatat rinore ku ata zhvillojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre kryesisht në fushën e mjedisit, kulturës dhe artit, mbrojtjen e trashëgimisë historike-kulturore, turizmit dhe përfshirjen në jetën sportive. Konkretisht janë kategorizuar në katër programe: *Edukimi social mjedisor; Edukimi kulturor dhe artistik. Edukimi i kulturës sportive dhe Edukimi Inovativ*

*Edukimi jo-formal i rinisë sipas nenit 3/b të Ligjit 'Për Rininë' 'është çdo veprimtari e organizuar dhe e përshtatur për të rinjtë, jashtë sistemit formal të arsimit, i bazuar në nevojat dhe interesat e të rinjve, parimet e vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes aktive të të rinjve në proceset e të nxënies, nëpërmjet të cilit fitojnë kompetenca të nevojshme për zhvillimin e potencialit personal, pjesëmarrjes aktive në shoqëri dhe aksesit në tregun e punës.'*

Një ndër elementët e rëndësishëm që ndikon pozitivisht në edukimin jo-formal është përfshirja e të rinjve në projekte inovative dhe kreative, ku ata përfshihen direkt në zbatim të projekteve, gjë që ka ndikim pozitiv në plotësimin e njohurive praktike që të rinjtë i përvetësojnë gjatë ciklit normal të edukimit. Këtu përfshihen veprimtari të organizuara nga BL apo partnerë sociale. Përmes kësaj iniciative, të rinjtë zbulojnë dhe zhvillojnë të menduarit kritik, për të përcjellë ide të reja në zgjidhjen e problemeve, për të menduar jashtë kornizave, për të gjetur gjuhën e përbashkët, krijuar miqësi dhe për t'u argëtuar. Përmes aktiviteteve të ndryshme, të rinjtë kanë mundësi të mësojnë më shumë rreth barazisë gjinore, demokracisë, përfshirjes sociale, mjedisit, të drejtave të njeriut, paqes dhe bashkëjetesës.

Synohet të realizohet ndërgjegjësim mbi situatën aktuale dhe rreziqet e mundshme që mund të vijnë nga ngrohja globale. Paralelisht, edukimi shëndetësor është i rëndësishëm dhe jo mjaftueshëm i trajtuar në kurrikulën e edukimit formal dhe përmes këtij programi, Bashkia do të marrë fushata ndërgjegjësimi mbi këtë çështje.

Kultura sportive do të projektohet në aktivitete të mirëfillita rinore që do të nxisin shpirtin garues dhe njëkohësisht do të orientojnë të rinjtë drejt aktiviteteve të shëndetshme të kohës së lirë. Sporti është një nga mënyrat më të sukseshme për të kultivuar ndjenjën e të punuarit në grup dhe që ka ndikim jo vetëm në shëndetin e të rinjve por edhe në nxitjen e bashkëveprimit të tyre.

Eksperienat e të rinjve kanë treguar se ka një boshllëk midis njohurive dhe përgatitjes që u bëhet atyre në institucionet arsimore dhe aftësive dhe kapaciteteve gjithmonë e në rritje që kërkon tregu i punës. Nga ana tjetër, programet e edukimit tradicional bëjnë pak ose aspak në drejtim të nxitjes së shpirtit të sipërmarrjes dhe inovacionit. Nisur nga kjo problematikë nëpërmjet edukimit inovativ synohet rritja e interesit të të rinjve për të marrë iniciativa në fushën e teknologjisë, si dhe krijimin e një rrjeti të rinjsh që synojnë të zhvillojnë një karrierë në teknologji.

2-EDUKIMI JO-FORMAL I TË RINJVE					
Programe	Projekte/aktivitete	Indikatorë	Target për indikator	Rezultate	Planifikuar në pba 2023-2025
<b>Edukimi social mjedisor</b>	1. Fushata informuese, advokuese dhe ndërgjegjësuere ne mbrojtjen e mjedisit; 2. Fushata sensibilizuese të organizuara nga BL dhe rrjeti i organizatave rinore për respektimin e të drejtave të njeriut; 3. Fushatë antibullizmi të organizuara nga BL; 4. Fushata sensibilizuese dhe informuese në shkolla lidhur me rëndësinë e mjedisit; 5- Aktivitete edukuese dhe ndërgjegjësuere mbi shëndetin, aspektet gjinore dhe integrimin e të rinjve në shoqëri.	1. Numri i fushatave dhe pjesëmarrësve në to; 2. Numri i pjesëmarrësve në fushatë ndërgjegjësuere; 3. Numri i pjesëmarrësve; 4. Numri i fushatave dhe pjesëmarrësve në to; 5. Numri i pjesëmarrësve në aktivitete dhe numri i aktiviteteve sipas temave.		- Ndërgjegjësimi i të rinjve lidhur me parandalimin e fenomeneve negative sociale të shoqërisë; - Më shumë informacion mbi përgjegjësitë dhe detyrimin për respektimin e të drejtave të njeriut; - Sistem informacioni mbi sjelljet dhe mekanizmat që parandalojnë	<b>Programi Menaxhimi i Mbetjeve 05100:</b> 1-Ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrje e publikut në mbrojtjen mjedisore. 2- Aktivitete ndërgjegjësimi me grupmoshat, me bizneset për mbrojtjen e mjedisit. <b>Programi Sport dhe Argëtim 08130:</b> 1.- Masivizimi i sporteve tek të rinjtë, mbështetja dhe zhvillimi i multidisiplinave sportive dhe zbulimi i talenteve të reja në sport. 2. Rritja e numrit të pjesëmarrësve në disiplinat sportive. <b>Programi Arsim i Mesëm i Përgjithshëm 09230:</b> Numri i përfituesve në aktivitetet kulturore e artistike. Numri i përfituesve në aktivitete tematike dhe ndërgjegjësuere.

## 2-EDUKIMI JO-FORMAL I TË RINJVE

Programe	Projekte/aktivitete	Indikatorë	Target për indikator	Rezultate	Planifikuar në pba 2023-2025
<b>Edukimi kulturor dhe artistik.</b>	<p>1. Organizimi i konkurseve të ndryshme kulturore mes shkollave, mbi çdo lloj fushe të artit me iniciativën e BL-së.</p> <p>2. Rritja e numrit të aktiviteteve kulturore artistike nga Bashkia e Lezhës ku mund të promovohen edhe të rinj të talentuar;</p> <p>3. Mbështetja e organizimit të festivaleve të ndryshme, rinore, kombëtare apo ndërkombëtare;</p> <p>4. Krijimi i Klubeve Rinore si pershembull: Klubi i Teatrit, Klubi Social, Klubi i Multimedias, Klubi i Sporteve, Klubi i Mjedisit, pranë qendrës rinore apo qendra multifunkionale, etj.;</p> <p>5. Krijimi i një hapësire në faqen zyrtare të BL-së ku mund të publikohen aktivitete rinore kulturoro-artistikosociale si më poshtë: Art, Sport, Mjedis, Trashëgimi Kulturor, etj e ngritur.</p> <p>6. Numri i vizitave kulturore mes shkollave te njesive administrative.</p> <p>7. Numri i punëtorive, trajnimeve dhe shkollave verore për të rinjtë nga Njësitë Administrative.</p>	<p>1. Numri i konkurseve të realizuara dhe numri i pjesëmarrësve;</p> <p>2. Numri i aktiviteteve të shtuara;/ Numri i përfituesve ne aktivitetet kulturore e artistike.</p> <p>3. Numri i festivaleve te organizuara;</p> <p>4. Numri i klubeve rinore të krijuara dhe numri i frekuentuesve;</p> <p>5. Hapësirë e dedikuar ku mund të publikohen aktivitete rinore kulturoro-artistikosociale si më poshtë: Art, Sport, Mjedis, Trashëgimi Kulturor, etj e ngritur.</p> <p>6. Numri i vizitave kulturore mes shkollave te njesive administrative.</p> <p>7. Numri i punëtorive, trajnimeve dhe shkollave verore për të rinjtë nga Njësitë Administrative.</p>		<p>dhe frenojnë bullizmin;</p> <p>- Më shumë të rinj të ndërgjegjësuar mbi rëndësinë e mjedisit dhe mbrojtjen e tij për të të përmirësuar cilësinë e jetës;</p> <p>- Më shumë mekanizma dhe hapësira për informimin e të rinjve në shkolla;</p> <p>- Më shumë mundësi për të shprehur talentin e tyre në fusha të ndryshme;</p> <p>- Më shumë aktivitete rinore kulturore dhe artistike;</p> <p>- Lehtësi në aksesimin e informacionit mbi eventet rinore në BL;</p> <p>- Ndërthurja e edukimit me aktivitetin fizik për jetë më të shëndetshme;</p> <p>- Përfshirja e shtresave të marginalizuara të të rinjve në aktivitete;</p> <p>- Përfshirja më e madhe e të rinjve në jetën sportive duke shfrytëzuar qendrat komunitare;</p>	<p>Numri i përfituesve në aktivitetet të tjera rinore. Numri i përfituesve pagesa për bursa.</p> <p>Fushata sensibilizimi/ndergjegjesimi per mjedisin;</p> <p>Vizita kulturore mes shkollave te njesive administravtive.</p> <p>Aktivitet per Diten e Rinise;</p> <p>Art Fest Lissus;</p> <p>Nxitja e mendimit kritik/aktivitete debati midis nxenesve te insitucioneve arsimore publike dhe private.</p>

**2-EDUKIMI JO-FORMAL I TË RINJVE**

<b>Programe</b>	<b>Projekte/aktivitete</b>	<b>Indikatorë</b>	<b>Target për indikator</b>	<b>Rezultate</b>	<b>Planifikuar në pba 2023-2025</b>
<b>Edukimi i kulturës sportive.</b>	<p>1. Zhvillimi i trajnimeve dhe aktiviteteve outdoor;</p> <p>2. Rrjetëzimi i aktiviteteve outdoor dhe që zgjasin në kohë;</p> <p>3. Terapi arti për të rinjtë PAK;</p> <p>4. Jetezimi i shkollat si qendra komunitare duke i pasuruar aktivitete sportive në zonat urbane dhe rurale.</p> <p>5. Masivizimi i sporteve tek të rinjtë, mbështetja, zhvillimi i multidisiplinave sportive dhe zbulimi i talenteve të reja në sport.</p>	<p>1. Numri i pjesëmarrësve në trajnime dhe numri i trajnimeve të realizuara;</p> <p>2. Numri i aktiviteteve outdoor;</p> <p>3. Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet terapeutike;</p> <p>4. Numri i shkollave në programin qendra komunitare, numri i aktiviteteve të realizuara në program dhe numri i pjesëmarrësve.</p> <p>5. Numri i të rinjve sportisë të mbështetur.</p> <p>5.1. Numri i sportistëve të rinj (femra dhe djem) pjesëmarrës në disiplinat sportive.</p>		<p>- Të rinj të kualifikuar me njohuri mbi teknologjinë;</p> <p>- Të rinj sipërmarrës në fushën e inovacionit.</p>	
<b>Edukimi Inovativ</b>	<p>1. Ofrimi i kurseve të programimit për të rinjtë;</p> <p>2-Nxitja e kulturës sipërmarrëse nëpërmjet trajnimeve/hackathon për idetë inovative e të tjera, në ambientet rekreative të ngritura apo mbështetura nga BL apo partnerë socialë/OJF rinore/për rininë. Zhvillimi i programeve të edukimit digjital UPSHIFT, Ponder për fëmijët në sipërmarrje, aftësim digjital, inovacion social, qytetari aktive, avokati, mendim kritik dhe mendim mediatik.(AKDF)</p> <p>3. Nxitja e mendimit kritik/aktivitete debati</p>	<p>1. Numri i të rinjve që frekuentojnë programet për kodimin;</p> <p>2- Numri i të rinjve që marrin pjesë në aktivitete që promovojnë kulturën sipërmarrëse dhe novacionin.</p> <p>3. Numri i nxenesve të insititucioneve arsimore publike dhe private që angazhohen në aktivitete debati.</p> <p>4. Numri i perdoruesve të rinj të platformave inovative për të shprehur zërin e</p>			

2-EDUKIMI JO-FORMAL I TË RINJVE

Programe	Projekte/aktivitete	Indikatorë	Target për indikator	Rezultate	Planifikuar në pba 2023-2025
	<p>midis nxenesve te insititucioneve arsimore publike dhe private.</p> <p>4.Zgjerimi dhe përdorimi i teknologjisë digjitale dhe platformave inovative si “U-report” për të realizuar të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar për të ngritur zërin për çështje që i prekin nga afër online dhe offline me mbeshtetjen e UNICEF. (AKDF)</p>	tyre.			

### Objektivi strategjik 3. Përfaqësimi, pjesëmarrja dhe integrimi në BE.

Dy janë programet mbi të cilën do të kategorizohen aktivitetet dhe projektet: *Informimi, Konsultimi dhe Përfaqësimi i të rinjve në vendimmarrje* si dhe *Vullnetarizmi*. Ky objektivi do të realizohet nëpërmjet zbatimit të projekteve konkrete lidhur me rritjen e informimit, përfaqësimit të të rinjve në proceset e vendimmarrjes në BL, ndërgjegjësimin dhe edukimin e të rinjve për pjesëmarrjen në proceset zgjedhore si e drejtë demokratike e shprehjes së vullnetit duke projektuar kështu rininë si aleatin e saj më të mirë në bashkëqeverisjen e saj. Po ashtu planifikohet informimi i të rinjve për Bashkimin Evropian dhe mundësitë që ofrohen për të rinjtë nga programe të BE-se në edukim, trajnim, ERASMUS etj. Nxitja e vullnetarizmit është po ashtu program kyç nën të cilin janë parashikuar një sërë masash.

#### 3-PËRFAQËSIMI, PJESËMARRJA DHE INTEGRIMI NË BE NË

Programe	Projekte/aktivitete	Indikatorë	Target për indikator	Rezultate	Planifikuar në pba 2023-2025
<b>Informimi, Konsultimi dhe Përfaqësimi i të rinjve në vendimmarrje</b>	<p>1. Fuqizimi i të rinjve të Këshillit Vendor Rinor;</p> <p>2. Përfshirja e të rinjve në konsultimet dhe procesin e hartimit të buxhetit të rinisë në BT;</p> <p>3. Fushata ndërgjegjësimi për informimin e të rinjve mbi funksionimin e Bashkisë Lezhë, Këshillit Bashkiak dhe komisioneve pranë këtij të fundit në bashkëpunim dhe me partnerë sociale, OJF rinor dhe për të rinjtë;</p> <p>4. Organizimi dhe zhvillimi i konsultimeve, seancave dëgjimore me të rinjtë sidomos për vendimmarrje të cilat prekin drejtpërdrejt grupmoshën e të rinjve.</p> <p>5. Informimi i të rinjve për Bashkimin Evropian dhe mundësitë që ofrohen për të rinjtë nga programe të BE-se për të rinjtë: edukim, trajnim, ERASMUS etj.</p> <p>6. Mbeshtetja e të rinjve të cilët deshirojnë të aplikojnë për programe të BE-se për të rinjtë.</p> <p>7. Zgjerimi dhe përdorimi i teknologjisë digjitale dhe platformave inovative si "U-report" për të realizuar të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve në nivel lokal,</p>	<p>1. Këshill Vendor Rinor aktiv dhe me kontribut substancial;</p> <p>2. Mekanizma funksionale që rrisin transparencën;</p> <p>Numri i të rinjve pjesëmarrës në konsultimet për buxhetin;</p> <p>3. Numri i fushatave të ndërgjegjësimit dhe numri i të rinjve pjesëmarrës në to;</p> <p>4. Numri i seancave dëgjimore çdo vit.</p> <p>5. Numri i seancave të informimit për Bashkimin Evropian dhe mundësitë që ofrojnë programet evropiane.</p> <p>5.1 Numri i të rinjve përfitues ne total pjesëmarrës nga keto seanca;</p> <p>6. Numri i të rinjve të cilët</p>		<p>-Rritja e përfaqësimit të të rinjve në vetqeverisje; B3;</p> <p>- Më shumë transparencë mes të rinjve dhe BL;;</p> <p>- Përfshirja e të rinjve në procesin e hartimit të buxhetit të rinisë dhe përdorim më i mirë i fondit për rininë;</p> <p>- Rritja e njohurive të të rinjve për procedurat administrative dhe vetëqeverisjen vendore;</p> <p>- Më shumë kërkesë llogarie nga të rinjtë.</p> <p>-Te rinjtë informuar mbi mundësitë që ofrohen nga programe të BE-se për të rinjtë: edukim, trajnim, ERASMUS etj. dhe që përfitojnë prej tyre.</p>	<p><b>Programi Shërbimet e Policisë Vendore 03140:</b> Numri i përfituesve nga Këndi i BE/Informacion i marrë nga qytetarët për Bashkimin Evropian.</p> <p><b>Programi Arsimit të Mesëm i Pergjithshëm 09230:</b> Aktivitetet për rininë: Fuqizimi i të rinjve të Këshillit Vendor Rinor;</p>

**3-PËRFAQËSIMI, PJESËMARRJA DHE INTEGRIMI NË BE NË**

Programe	Projekte/aktivitete	Indikatorë	Target për indikator	Rezultate	Planifikuar në pba 2023-2025
	kombëtar dhe ndërkombëtar për të ngritur zërin për çështje që i prekin nga afër online dhe offline	mbeshteten për aplikuar për programe të BE-se për të rinj.			
<b>Vullnetarizmi</b>	<p>1. Ofrimi i asistencës teknike dhe mjedisive fizike për aktivitetet vullnetare që organizojnë të rinjtë dhe organizatat rinore/per të rinjte;</p> <p>2. Vendosja e marrëveshjeve me institucionet e edukimit jo-formal/OJF-ve në lidhje me praktika të vullnetarizmit;</p> <p>3. Krijimi i rrjetit të të rinjve vullnetarë për mbështetjen e të rinjve me aftësi të kufizuar për ti shoqëruar në aktivitete të ndryshme duke i trajnuar dhe dhënë aftësitë e nevojshme për mbështetjen e kësaj kategorie;</p> <p>4. Promovimi i punës vullnetare ndërmjet të rinjve</p>	<p>1. Numri i mjedisive fizike dhe numri i organizatave që i shfrytëzojnë këto mjedisive;</p> <p>2. Numri i marrëveshjeve të nënshkruara;</p> <p>3. Numri i vullnetarëve në rrjet;</p> <p>5. Numri i të rinjve të aktivizuar nga zonat rurale.</p>		<p>- Ngritja dhe forcimi i urave të bashkëpunimit ndërmjet të rinjve dhe organizatave rinore;</p> <p>- Shkëmbimi i eksperiencave ndërmjet të rinjve dhe organizatave rinore;</p> <p>- Forcimi i konceptit dhe praktikës së vullnetarizmit;</p> <p>- Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet të rinjve duke fuqizuar praktikat sociale;</p> <p>- Përfshirja e të gjithë të rinjve në territorin e BT-së në promovimin e</p>	<p><b>Programi Arsimit të Mesëm i Përgjithshëm 09230:</b></p> <p>1-Rritja e numrit të aktiviteteteve rinore.</p>

**3-PËRFAQËSIMI, PJESËMARRJA DHE INTEGRIMI NË BE NË**

<b>Programe</b>	<b>Projekte/aktivitete</b>	<b>Indikatorë</b>	<b>Target për indikator</b>	<b>Rezultate</b>	<b>Planifikuar në pba 2023-2025</b>
	të zonave rurale;			vullnetarizmit.	



## Objektivi strategjik 4. Siguria Sociale për të rinjtë.

Ky objektivi do të garantojë ngritjen dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve të përkujdesit social vendor dhe fuqizimin e bashkëpunimit të BL-së me organizatat rinore dhe organizatat që punojnë edhe për rininë për parandalimin e fenomeneve të rrezikshme sociale. Ngritja dhe siguri i qëndrueshmërisë së shërbimeve të përkujdesit social vendor. Programet të cilat synojnë të realizojnë objektivin janë: *Ngritja dhe siguri i qëndrueshmërisë së shërbimeve të përkujdesit social vendor dhe Fuqizimi i bashkëpunimit të BL-së me organizatat rinore dhe organizatat për rininë për parandalimin e fenomeneve të rrezikshme sociale për të rinjtë dhe*

4-SIGURIA SOCIALE PËR TË RINJTË					
PROGRAME	PROJEKTE/AKTIVITETE	INDIKATORË	TARGET PËR INDIKATOR	REZULTATE	Planifikuar në PBA 2023-2025
<p><b>Ngritja dhe siguri i qëndrueshmërisë së shërbimeve të përkujdesit social vendor.</b></p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Krijimi i një programi strehimi social për grupet e të rinjve në nevojë ekonomike dhe sociale;</li> <li>Zhvillimi i një pakete me shërbime për të rinj pa kujdes prindëror, që dalin nga kujdesi;</li> <li>Ridimensionimi, rritja e buxhetit të bashkisë për zhvillimin e shërbimit të kujdestarisë;</li> <li>Karta e Studentit për studentët Lezhianë që përfitojnë nga ulje cmimesh për shërbime të ndryshme në Bashkinë e Lezhës (SKA);</li> <li>Krijimi i rrjeteve të Edukatorëve Bashkëmohatar për grupet e marxhinalizuara;</li> <li>Pajisja me infrastrukturën e duhur për të rinjtë PAK në mjediset publike më të frekuentuara duke përfshirë dhe sinjalistikat rrugore për të rinjtë me AK.</li> <li>Ndërimi i Qendrës Sociale për PAK;</li> <li>Mbështetja e fëmijëve me AK me shërbim në banesë;</li> <li>Ofrimi i bursave si model stimulues për nxënës ekselentë;</li> <li>Ofrimi i bursave si model stimulues për studentët lezhianë.</li> <li>Mbështetje me strehim emergjent për vajzat/gratë e reja me urdhër mbrojtje.</li> <li>Rritje e pjesëmarrësve të numrit të PAK në kurset profesionale.</li> <li>Sigurimi i transportit publik urban për të lidhur qytetin me njësitë administrative çdo një orë duke siguruar ndërlidhjen e të rinjve.</li> <li>Planifikimi i buxheteve për sigurimin e materialeve</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Numri i të rinjve përfitues nga ky program;</li> <li>Paketë shërbimesh e krijuar;</li> <li>Buxheti i shtuar për shërbimet e kujdestarisë;</li> <li>Numri i studentëve lezhianë të pajisur me kartë studentit që përfitojnë nga ulje cmimesh në Bashkinë Lezhë;</li> <li>Rrjet funksional i edukatorëve bashkëmohatarë;</li> <li>Numri i mjediseve publike rinore/infrastruktura rrugore të pajisura me infrastrukturën PAK;</li> <li>Qendër Sociale për PAK e ngritur;</li> <li>Numri i fëmijëve me AK me shërbim në banesë;</li> <li>Numri i nxënësve të stimuluar me bursa;</li> <li>Numri i bursave për studentë.</li> <li>Numri i përfituesve femra/vajza të reja në strehim emergjent.</li> <li>Përqindja e personave PAK pjesëmarrës në kurset profesionale dhe të punësimit.</li> <li>Numri i linjave të transportit publik ofruar çdo 1 orë.</li> <li>Shuma e buxhetit të planifikuar si ze me</li> </ol>		<ul style="list-style-type: none"> <li>-Shërbime sociale të përmirësuara që mbulojnë grupmoshat rinore;</li> <li>-Programet e strehimit social vetëm për rininë;</li> <li>-Lehtësi për aksesin e institucioneve artistike, kulturore dhe sociale nga pajisja me Kartën e Studentit;</li> <li>-Përmirësimi i kushteve ekonomike dhe sociale për të rinjtë;</li> <li>-Mbulimi i mirë i territorit me Shërbime për të rinjtë;</li> <li>-Përmirësimi i kushteve për studentët; Barazi në aksesin e shërbimeve nga të gjitha grupet e marxhinalizuara rinore.</li> <li>- Qendër Sociale për PAK e ngritur;</li> <li>- Fëmijëve me AK mbështetur me shërbim në banesë;</li> <li>-Mbështetja e vajzave/grave të reja me urdhër mbrojtje.</li> <li>-Të rinj PAK të aftësuar për</li> </ul>	<p><b>Programi 10430 Përkujdesi Social:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Ndërtimi i Qendrës Sociale për PAK në vitin 2025</li> <li>- Fëmijë me AK të mbështetur në banesë/rritja e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuar në banesa;</li> <li>-Mbështetje me strehim emergjent për vajzat/gratë me urdhër mbrojtje.</li> <li>-Rritje e pjesëmarrësve të numrit të PAK në kurset profesionale.</li> </ul> <p><b>Programi Arsimit Mesëm i Përgjithshëm 09230:</b></p> <p>Aktivitetet për rininë: Shperblimi i maturanteve me të mire.</p>

**4-SIGURIA SOCIALE PËR TË RINJTË**

PROGRAME	PROJEKTE/AKTIVITETE	INDIKATORË	TARGET PËR INDIKATOR	REZULTATE	Planifikuar në PBA 2023-2025
	<p>didaktike sipas kërkesave të veçanta të kategorive të ndryshme të nxeensve me aftësi të kufizuara ne shkolla. (AKDF)</p> <p>15. Organizim i programeve të vecanta mbasshkollore ku nxënësit romë dhe egjiptianë të moshës 6-16 vjeç të ndihmohen në kryerjen e detyrave mësimore ose marrin mësim plotësuese. (PKVIRE)</p> <p>16. Rritja e subvencionimit shtesë, pjesë e skemës së ndihmës ekonomike, për nxënësit romë dhe egjiptianë që ndjekin rregullisht arsimin e detyrueshëm.(PKVIRE)</p>	<p>vete per sigurimin e materialeve didaktike ipas kërkesave të veçanta të kategorive të ndryshme të nxeensve me aftësi të kufizuara ne shkolla.</p> <p>15. Numri te rinjve romë dhe egjiptianë të moshës 6-16 vjeç të ndihmohen në kryerjen e detyrave mësimore ose marrin mësim plotësuese.</p> <p>16. Subvencionimi shtesë, pjesë e skemës së ndihmës ekonomike, për nxënësit romë dhe egjiptianë që ndjekin rregullisht arsimin e detyrueshëm.</p>		<p>punësim nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së tyre në kurset profesionale dhe të punësimit.</p> <p>- Numri i linjave të transportit midis NJA-ve cdo 1 orë që sigurojnë transport për të rinjtë.</p> <p>--Mbeshtetje e nxeensve me AK, uke patur buxhet te planifikuar si ze me vete per sigurimin e materialeve didaktike ipas kërkesave të veçanta të kategorive të ndryshme të nxeensve me aftësi të kufizuara ne shkolla.</p>	
<p><b>Fuqizimi i bashkëpunimit të BL-së me organizatat rinore dhe organizatat për rininë për parandalimin e fenomeneve të rrezikshme sociale për të rinjtë</b></p>	<p>1. Organizimi i Panaireve të Organizatave Rinore;</p> <p>2. Ofrimi i asistencës teknike dhe asetëve fizike të BL për aktivitetet që organizojnë të rinjtë dhe organizatat rinore;</p> <p>3. Mundësimi i shkëmbimeve të ndryshme rinore, mes të rinjve, organizatave rinore me qytetet binjake, me të cilat Bashkia e Lezhë ka lidhur marrëveshje binjakëzimi.</p> <p>4. Mbeshtetja e Organizatave të Shoqërisë Civile me grante nga Bashkia.</p> <p>5. Ngritja e bashkëpunimeve/mbeshtetjes me OSHC rinore/per rinine per aplikime ne kuader te thirrjeve per projekte ne nivel lokal, kombetar apo nderkombetar</p>	<p>1. Numri i panaireve rinore dhe numri i organizatave pjesëmarrëse;</p> <p>2. Numri i asetëve të ofruara nga BL;</p> <p>3. Numri i aktivitetëve për shkëmbimin e eksperiencave.</p> <p>4. Numri i OSHC (rinore/për rininë) që mbështeten me grant nga Bashkia.</p> <p>5. Numri i projekteve te fituara ne te cilat Bashkia eshte partner me apo mbeshtetes i OSHC-ve rinore/per te rinjte.</p>		<p>Bashkëpunim më i frytshëm ndërmjet organizatave rinore;</p> <p>- Forcimi i zërit rinor;</p> <p>- Më shumë hapësira dhe infrastrukturë në dispozicion të aktivitetëve rinore.</p> <p>'- OSHC-rinore/per rinine te mbeshtetura me grante nga Bashkia.</p>	<p><b>Programi Shërbimet e Policisë Vendore 03140:</b></p> <p>Numri i OSHC që mbështeten nga Bashkia.</p>

**4-SIGURIA SOCIALE PËR TË RINJTË**

<b>PROGRAME</b>	<b>PROJEKTE/AKTIVITETE</b>	<b>INDIKATORË</b>	<b>TARGET PËR INDIKATOR</b>	<b>REZULTATE</b>	<b>Planifikuar në PBA 2023-2025</b>
	duke shfrytëzuar.				

## Objektivi strategjik 5. Mbështetja financiare dhe nxitja e punësimit.

Ky objektivi synon përmirësimin e instrumentave, burimeve të informacionit dhe alternativat për punësimin apo vetëpunësimin e të rinjve. BL do të krijojë më shumë mundësi për të rinjtë që duan të hapin një biznes, që të gjejnë asistencën dhe hapësirat e nevojshme për të ushtruar këtë të drejtë të tyre. Nën këtë objektivi parashikohen politika/projekte dhe aktivitete të cilat prodhojnë skema dhe mekanizma nxitës dhe lehtësues për të rinjtë që dëshirojnë të hapin biznesin e tyre (start-up) ose të zhvillojnë biznesin ekzistues.

Fokus i kushtohet dhe të rinjve në zonat rurale duke synuar të mbështetje me skema financimi për ide sipërmarrese si pershembull në artizanat, prodhim i bimëve medicinale, kopshtari etj. Po ashtu, të rinjtë e zonave rurale do të synohet të informohen mbi mundësitë për përfitim nga burime financiare të ndryshme për bizneset e tyre. Këto mund të jenë si fonde publike ato të ndihmës së huaj si pershembull mbështetja e fondeve IPARD, e të tjera.

Në këtë drejtim, bashkëpunimi me AZHBR-në, si institucioni i akredituar për administrimin e fondeve nga BE, fokusuar në zhvillimin e bujqësisë së qëndrueshme dhe diversifikimin e ekonomisë rurale, do të ishte me vlerë për sa i përket informimit dhe mbështetjes së të rinjve mbi mundësitë dhe procedurat e aplikimit. Mbështetja e biznesit rinor në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit parashikohet të ketë peshën e vetë në këtë program.

5-MBËSHTETJA FINANCIARE DHE NXITJA E PUNËSIMIT TË TË RINJVE					
PROGRAME	PROJEKTE/AKTIVITETE	INDIKATORË	TARGET PËR INDIKATOR	REZULTATE	Planifikuar në PBA 2023-2025
Punësimi dhe vetëpunësimi i të rinjve	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ngritja e nje Fondi per Program Nxitjeje së Punësimit në Ndhmë të Krijimit të Biznesit Social Rinor;</li> <li>2. Krijimi i një paketë lehtësuese fiskale për bizneset rinore.</li> <li>3. Lobim në strukturat e shtetit për të sjell në Lezhë një filial të Qendrave të Formimit Profesional.</li> <li>4. Mbështetje me skema financimi të të rinjve në zonat rurale me ide sipërmarrese si pershembull: artizanat, prodhim i bimëve medicinale, kopshtari etj.</li> <li>5. Ofrimi i informacionit te strukturuar per te rinjte e zonave rurale mbi mundesi aplikimi nga fonde/grante qe targetojne bujqesine/blektorine ne bashkepunim me keto institucione si AZHBR per fondet IPARD.</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Numri i bizneseve sociale rinore fituese;</li> <li>2. Paketë fiskale lehtësuese për te rinjtë funksionale dhe numri i të rinjve përfitues nga paketa.</li> <li>3. Qender e formimit profesional e ngritur.</li> <li>4. Numri i bizneseve te te rinjve ne zonat rurale te mbeshtetura me skema financimi/grantimi publike apo jo publike.</li> <li>5. Numri i te rinjve ne zonat rurale te mbeshtetur me informacion per aplikim ne skema financimi/grantimi per ide biznesi.</li> </ol>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Më shumë mundësi për punësim dhe vetëpunësim për të rinjtë në territorin e BL-së;</li> <li>- Mbështetje financiare për nismat rinore që gjenerojnë punësim;</li> <li>- Lehtësim i aksesit në tregun e punës për të rinjtë;</li> <li>- Akses online në portali i punësimit;</li> <li>- Më shumë informacion rreth mundësive për punësim;</li> <li>- Lehtësi fiskale për bizneset rinore;</li> <li>- Zhvillim dhe trajnime për rritjen e kapaciteteve dhe kualifikime për të</li> </ul>	

5-MBËSHETETJA FINANCIARE DHE NXITJA E PUNËSIMIT TË TË RINJVE

PROGRAME	PROJEKTE/AKTIVITETE	INDIKATORË	TARGET PËR INDIKATOR	REZULTATE	Planifikuar në PBA 2023-2025
<b>Rritja e kapaciteteve të rinjve për tu integruar sa më mirë në tregun e punës</b>	<p>1. Ofrimi i trajnimeve dhe kurseve të formimit për të rinjtë mbi sipërmarrjen, taksimin, mundësitë e biznesit, procedurat vendore etj.;</p> <p>2. Mbështetja e një qendre IT për programe për mbështetjen dhe qëndrueshmërinë e Inkubatorëve të Biznesit/ zhvillimin aftësive teknologjike.</p> <p>3. Promovimi dhe nxitja e bizneseve inovatore dhe atyre sociale rinore;</p> <p>4. Mundësimi i praktikave profesionale në BL dhe institucionet në varësi të BL-së;</p> <p>5. One-stop shops që ofrojnë soft skills dhe informacion për të rinjtë (si të shkruajnë cv, emaile, letra motivimi etj.) Sigurimi i mundësi punësimit dhe vetëpunësimit.</p> <p>6. Mbështetja e hapjes së një Qendre Këshillimi për Karrierë.</p> <p>7. Identifikimi i të rinjve NEET ne kuader te skemes se Garancise Rinore drejtuar nga MFE dhe Agjencia Kombetare e Arsimit dhe Formimit Profesional me qellim ofrimin e nje oferte cilesore formimi/arsimi/punesimi brenda nje periudhe 4 mujore si pjese e kesaj skeme. (Draft strategjia e Punesimit dhe Aftesive)</p>	<p>1. Numri i trajnimeve të zhvilluara për të rinjtë dhe numri të rinjve të trajnuar;</p> <p>2. Numri i bizneseve rinore të inkubuar;</p> <p>3. Numri i bizneseve rinore të mbështetura apo promovuara;</p> <p>4. Numri i studentëve që kanë kryer praktikën;</p> <p>5. Numri i one-stop-shop dhe numri i të rinjve që i frekuentojnë;</p> <p>6. Hapja e një Qendre Këshillimi për Karrierë</p> <p>7. Numri i të rinjve NEET te identifikuar dhe regjistruar ne Bashkinë Lezhe.</p>		<p>rinjtë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Promovimi i bizneseve rinore;</li> <li>- Më shumë pjesëmarrës në programin e praktikave.</li> <li>- Filial i Qendrave të Formimit Profesional i hapur në BL.</li> <li>-Te rinj NEET te arritur te cileve u sigurohet nje oferte cilesore.</li> <li>- Mbështetje me informacion dhe skema financimi të të rinjve në zonat rurale me ide sipërmarrëse si pershembull: artizanat, prodhim i bimëve medicinale, kopshtari etj.</li> </ul>	

## 6. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PSVR-SË

Aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit janë një komponent thelbësor për të përmirësuar efektivitetin e vetëqeverisjes vendore. Monitorimi dhe vlerësimi siguron informacion mbi zbatimin e objektivave dhe programeve, që i mundëson BL-së të përfitojë nga sukseset dhe të mësojë nga eksperiencat e zbatimit. Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit kërkon përpjekje të përkushtuara, ekspertizë, aftësi, vlerësim dhe menaxhim të mirë.

Procesi i qartë i monitorimit dhe raportimit është i nevojshëm për të informuar pjesëmarrësit për përgjegjësitë e tyre dhe për t'u mundësuar atyre që të përgatiten për të gjitha angazhimet duke u bazuar në një kalendar të përcaktuar më parë. Sistemi i monitorimit duhet të jetë i mirëorganizuar për të ndjekur të gjitha hallkat që të mbulohen të gjitha projektet dhe të përcaktohen dhe konfirmohen strukturat monitoruese.

Kapaciteti i strukturave për të prodhuar informacion cilësor dhe për të konsoliduar informacionin është shumë i rëndësishëm. Duhet përpjekje dhe aftësi për të prodhuar informacion raportimi të mirë të bazuar në analiza dhe të mbështetur nga prova. Praktika në sektorin publik tregon se shumë shpesh raportimi i informacionit fokusohet në veprimet e përditshme rutinore më shumë sesa në analizën e arritjeve. Kapaciteti mund të përmirësohet përmes udhëzimeve, trajnimit dhe praktikës.

Struktura përgjegjëse për hartimin dhe monitorimin e strategjive pranë BL përcakton dhe sistemin e monitorimit bazuar në indikatorët e objektivave. Në këtë sistem përcaktohet: struktura përgjegjëse, periodiciteti kur mbledhet e dhëna dhe raportimi. Periodiciteti i monitorimit vendoset bazuar në specifikat që ka çdo projekt/aktivitet. Në bashkëpunim me njësitë përgjegjëse, përcaktohen targeti i synuar dhe gjendja aktuale e indikatorit në mënyrë që struktura përgjegjëse të realizojë ndjekjen e ecurisë për realizimin e indikatorit.

Si më poshtë gjendet matrica shembull për ngritjen e sistemit të monitorimit. Ngritja e këtij sistemi drejtohet nga struktura përgjegjëse për monitorimin e strategjive në bashkëpunim të ngushtë me strukturën përgjegjëse për sektorin e rinisë. Për hartimin përmbajtësor të saj ngrihet grup pune nga të gjitha njësitë të cilat kanë në përgjegjësi masa të parashikuara në PSVR. Në grup pune me vendim të Kryetarit të Bashkisë miratohet dhe struktura përgjegjëse për monitorimin e strategjive në BL.

Ky vlerësim do të realizohet çdo fund viti, ku nëpërmjet analizës së raporteve të monitorimit do të vlerësohet masa e përmbushjes së objektivave, krahasimi i masës së arritjeve me masën e parashikuar, si edhe në raste të veçanta do të propozohen edhe rishikime të objektivave strategjike, ndryshime në projekte, kohëzgjatje, afate, fonde etj. Shoqëria civile nxitet që të përgatisë raporte monitorimi mbi zbatimin e PSVR-së.

**Format Raporti i Monitorimit te Planit Strategjik Vendor për Rininë Bashkia Lezhë**

<b>Institucioni Raportues</b>	<b>Bashkia Lezhë</b>													
<b>Periudha e Raportimit</b>	<b>XXXX</b>													
<b>Objektivi 1: HAPËSIRAT DHE INFRASTRUKTURA RINORE</b>														
Programi	PROJEKTE / AKTIVITETE	Afati Kohor	Rezultatet e pritshme	Indikatoret	Target per tu arritur	Gjendja e indikatorit në periudhën e raportimit	Niveli i zbatimit të aktivitetit/projektit				Komente / shpjegim mbi realizimin e projektit/ aktivitetit / indikatorit/ nivelit të realizimit në narracion	Arsyet e mozbatimit ( ne rast kur aktiviteti/ projekti/ indikatori nuk eshte realizuar)	Rekomandime	Njesia qe raporton
Infrastruktura arsimore	Ndërtimi i shkollave të ciklit parauniversitar me standarde aksesueshmërie ;	2023-2027	Mbulim më i mirë i hapësirave urbane dhe rurale me shkolla që plotësojnë standardet e aksesueshërisë;	Numri i shkollave të reja me standarde të aksesushmerisë;	X shkolla të ciklit parauniversitar me standarde aksesueshmërie të ndërtuara brenda vitit 2027		E zbatuar teresisht	Pjeserisht	Filluar zbatimi / ne proces	Pa zbatuar				
<b>Raportimi Financiar</b>														
	Shpenzimet/ Alokimet		<b>Buxheti i shtetit</b>	<b>Donatore</b>			<b>Burime te tjera</b>							
	Shpenzimet financiare													
	Alokimet e pritura													





## 7. BIBLIOGRAFIA

- Programi Qeverisës 2021-2023, i disponueshëm në:  
[https://kryeministria.al/epcontent/uploads/2021/10/Programi\\_Qeverises\\_2021-2025.pdf](https://kryeministria.al/epcontent/uploads/2021/10/Programi_Qeverises_2021-2025.pdf)
- Ministria e Financave dhe Ekonomise, Draft Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023-2030, <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/561>
- United Nations, Youth 2030, 'Eëorking ëith and for young people',  
[b1d674\\_9f63445fc59a41b6bb50cbd4f800922b.pdf \(unyouth2030.com\)](https://www.un.org/development/desa/youth/2030/9f63445fc59a41b6bb50cbd4f800922b.pdf)
- European Union, Resolution of the Council of the European Union and the Representatives of the Governments of the Member States meeting ëithin the Council on a framëork for European cooperation in the youth field: The European Union Youth Strategy 2019-2027, Official Journal of the European Union, C 456, Volume 61, 18 December 2018, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=OJ:C:2018:456:FULL>
- Eëestern Balkans Agenda on Innovation, Research, Education, Culture, Youth & Sport, ec\_rtd\_ëestern-balkans-agenda-overvieë.pdf (europa.eu)
- Bashkia Lezhë, Plani Strategjik për Zhvillimin e Qëndrueshëm në Bashkinë Lezhë 2030, [https://lezha.gov.al/ep-content/uploads/2021/06/plani\\_strategjik\\_bashkia\\_lezhe\\_alb\\_730.pdf](https://lezha.gov.al/ep-content/uploads/2021/06/plani_strategjik_bashkia_lezhe_alb_730.pdf)
- Bashkia Lezhë, Plani Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, faqe 5, [PBA-2023-2025-Faza-e-dytë.pdf \(lezha.gov.al\)](https://lezha.gov.al/PBA-2023-2025-Faza-e-dytë.pdf)
- Bashkia Lezhë, Informacion mbi organizimin në Bashkinë Lezhë, <https://lezha.gov.al/drejtoria-e-arsimit-rinise-dhe-sporteve/>
- INSTAT (2022) Vjetari Statistikor Rajonal, ëëë.instat.gov.al
- NSTAT (2022) Burra dhe Gra 2022, faqe 14, ëëë.instat.gov.al
- INSTAT, Projeksionet demografike 2021-2030, <https://ëëë.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/projeksionet/#tab3>
- Ligji nr. 79/2019 'Për rininë'
- Bashkia Lezhë, Drejtoria e Arsimit, Rinise dhe Sporteve, në përgjigje të shkresës nr. 2881/3 Prot.
- Ligji nr. 79/2019 'Për Rininë''
- Bashkia Lezhë, Përgjigje shkresës nr. 2882/1 Prot. date 16.03.2023
- Bashkia Lezhë, 'Përgjigje shkresës' nr. 2881/1 Prot. date 28.03.2023
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 22.10.2021, 'Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj'
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 659, datë 3.11.2021 "Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026'

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 692, datë 26.10.2022 *'Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe planit të Veprimit', 2022-2029*
- Vendim i Kryetarit të Bashkisë Lezhë, nr. 515 date 4.12.2022 *'Emërimin e anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë'*
- Vendimi i Këshillit Bashkiak, nr. 44, datë 27.04.2022 të *"Për miratimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit vendor të rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit tij*